




C
Fonds

Prince Claus Fund for
Culture and Development

CH
WB

Cultural
Heritage without Borders
ALBANIA | KOSOVO

Qendra Ndërkombëtare për
Studimin e Ruajtjes dhe
Restaurimit të Pasurisë Kulturore



NDIHMA E PARË NDAJ TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOHË KRIZASH

2

**Paketa
e mjeteve**

NDIHMA E PARË NDAJ TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOHË KRIZASH

2. Paketa e mjeteve

*Për masat e sigurimit të trashëgimisë materiale dhe
jomateriale përmes përgjigjes së bashkërenduar dhe
gatishmërisë ndaj emergjencave.*

Aparna Tandon

Botuar nga Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICCROM), Via di San Michele 13, 00153 Romë, Itali;

nga Fondi Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim, Herengracht 603, 1017 CE Amsterdam, Holandë;

dhe nga Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij - Shqipëri (CHwB Albania), Rr. "Ismail Qemali", P.34/I Kt. VII Zy.31, Tiranë, Shqipëri, dhe Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosovo*), Rr. "Nezir Gashi", nr.38, Prishtinë, Kosovë*;

në kuadrin e bashkëpunimit mes ICCROM-it, "Prince Claus Fund" dhe Institutit Smithsonian për zhvillimin e kapaciteteve të gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave për trashëgiminë kulturore.

©ICCROM, Fondi Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim, Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij - Shqipëri (CHwB Albania), Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosovo*) 2023

ICCROM, Prince Claus Fund, Cultural Heritage Without Borders, 2022

ISBN 978-92-9077-330-6

CHwB Albania ISBN 9789928801074

CHwB Kosovo* ISBN 9789951895750

BASHKAUTORË

Autor dhe redaktor kryesor Aparna Tandon, ICCROM

KONTRIBUES TË FUSHAVE PËRKATËSE

Vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut, pas ngjarjes	Rohit Jigyasu, Eugénie Crété, Elke Selter
Sigurimi dhe stabilizimi	Eugénie Crété, Elke Selter, Xavier Romão, Esmeralda Paupério
Shembuj	María Cecilia Rodríguez Moreno, Eugénie Crété, Ihor Poshyvailo, Kyaw Myo Ko, Elke Selter, Valentina Spano, Layla Salih
Redaktimi shkencor	Jessica Doyle, Jonathan Eaton, Sonia Giovinazzi
Puna kërkimore	Jessica Doyle, Valentina Spano
Kompozimi grafik	Christopher Malapitan

KOORDINIMI

ICCROM	Catherine Antomarchi, Aparna Tandon, Jennifer Copithorne, Isabelle de Brisis & Isabelle Verger
Prince Claus Fund	Deborah Stolk

KOORDINIMI I PUBLIKIMIT NË GJUHËN SHQIPE

	Elena Mamani, Ana Pekmezi dhe Erinë Mulolli Zajmi CHwB Albania dhe CHwB Kosovo*
Përkthimi në shqip	Enkeleđa Roze, Anisa Mano, Marsela Plyku Demaj, Klodjana Gjata
Redaktimi gjuhësor	Rudina Çupi dhe Boiken Abazi

Përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe është mundësuar falë mbështetjes së Prince Claus Fund dhe CER.



Ky botim është në dispozicion në Open Access nën licencën Attribution-NonCommercial-ShareAlike 4.0 International (CC BY-NC-SA 4.0) (<https://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/>). Duke përdorur përmbajtjen e këtij botimi, përdoruesit pranojnë të kufizohen nga kushtet e përdorimit të Open Access ICCROM.

Përcaktimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e ICCROM-it dhe Fondit Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim lidhur me statusin ligjor të çdo vendi, territori, qyteti, zone ose autoriteteve të tij ose në lidhje me caktimin e kufijve ose zonave kufitare.

Idetë dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve; ato nuk janë domosdoshmërisht të ICCROM-it dhe të Fondit Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim dhe nuk krijojnë detyrime për këto Organizata.

*Referenca për Kosovën nuk paragjykon pozicionet rreth statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

PËRMBAJTJA

Përdorimi i <i>Paketës së mjeteve</i>	5
---	---



Vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut, pas ngjarjes

• Lista e kontrollit	8
• Përgatitja e planimetrisë së sitit dhe e një harte bazë.....	11
• Karakteristikat e një formulari vlerësimi të dobishëm ..	14
• Modele vlerësimi të dëmit dhe të riskut, pas ngjarjes.....	15
• Këshilla për mbledhjen e të dhënave për dëmet	26
• Dëmtimet tipike strukturore dhe jostrukturore	28



Sigurimi dhe stabilizimi

• Përcaktimi i rrjetit koordinativ për hartëzimin e vendngjarjes	39
• Krijimi i kodeve të vendndodhjes	41
• Caktimi i numrave unikë të identifikimit	42
• Dokumentimi i një evakuimi	44
• Dokumentimi i një operacioni shpëtimi	46
• Këshilla për trajtimin e objekteve	48
• Këshilla për paketimin	49
• Materiale të zakonshme organike dhe joorganike	53
• Klasifikimi sipas përparësisë.....	55
• Stabilizimi i trashëgimisë kulturore të luajtshme	57
• Materialet dhe pajisjet për evakuim dhe shpëtim	67
• Mbulesat e përkohshme	73
• Pajandimi bazë	79
• Këshilla për tharjen e strukturave të lagura.....	92
• Materiale dhe pajisje për stabilizimin emergjent të strukturave dhe ndërtesave	93

Referenca	97
------------------------	----

Orientimi në *Paketën e mjeteve*

Ju lutem të shihni më poshtë disa këshilla që do t'ju ndihmojnë të orientoheni te kjo *Paketë mjeteshe*.

SKEDAT E LIBRIT

Në anën e sipërme në të djathtë të çdo faqeje do të gjeni skeda interaktive, të cilat ju ndihmojnë të kaloni në seksionin që dëshironi të shihni te *Paketa e mjeteve*.

LIDHJET

Me gërma BLU dhe “bold”: Lidhje me pjesë të caktuara në dokument.



KËSHILLA: Këshilla të bazuara në përvojë.




KUJDES: Kërkohet vëmendje për të shmangur rreziqet dhe / ose gabimet e paparashikuara.




LEXONI MË SHUMË: Lexime plotësuese.



STRUKTURA E VEPRIMEVE TË NDIHMËS SË PARË NDAJ TRASHËGIMISË KULTURORE



VLERËSIMI NË VEND I DËMIT DHE RISKUT PAS NGJARJES



Lista e kontrollit për vlerësimin në vend të dëmit dhe e riskut

Siguria personale duhet të jetë përparësia kryesore kur ndërmerret një vlerësim në terren në zonat e prekura. Mbani parasysh këshillat e mëposhtme përpara se të shkoni në sit:

- ✓ Sigurohuni që të keni lejet e nevojshme për të hyrë në sit.
- ✓ Sigurohuni që të keni të paktën një mjet komunikimi, p.sh., një telefon celular ose radio "VHF".
- ✓ Mbani shënim numrat e telefonit të stacionit të policisë, të zyrave operacionale të policisë, stacionet zjarrfikëse, shërbimet e ndihmës së shpejtë në rast emergjence.
- ✓ Shmangni situatat e rrezikshme dhe jini të vetëdijshëm se pasojat e një katastrofe mund të përfshijnë risqe shtesë, si pasgoditjet e tërmetit, rrëshqitjet e tokës, plaçkitjet etj.
- ✓ Merrni informacion për mjediset që ju rrethojnë dhe lokalizoni zonën më të afërt që është e sigurt.
- ✓ Ruani qetësinë dhe bëni kujdes ku ecni.
- ✗ Mos shkoni në sit pa u pajisur me veshjet e posaçme të sigurisë.
- ✗ Mos u endni nëpër sit i vetëm ose pa e planifikuar më parë itinerarin tuaj.
- ✗ Kushtet e rrugës mund të jenë shumë të këqija dhe qasja shumë e kufizuar. Planifikojeni mirë udhëtimin tuaj dhe shmangni lëvizjen me automjet pasi errësohet.

Para mbërritjes në sit, sigurohuni që të keni pajisjet dhe mjetet e mëposhtme për të filluar vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut:



- ☐ Pajisje personale mbrojtëse
(shikoni listën e plotë në faqen tjetër)
- ☐ Formularët e vlerësimit të dëmit dhe të riskut
- ☐ Kamera, “smartphone” (telefon celular të teknologjisë inteligjente) ose tabletë elektronike për të bërë fotografi dhe për të regjistruar gjeo-koordinatat (nëse është e lejueshme). Në situata kur nuk lejohen as kamera, as telefoni celular, duhet të merret një tabletë elektronike për skica në sit dhe për të bërë shënime.
- ☐ Elektrik dore / fener me bateri rezervë
- ☐ Metër shirit, këmbalec dhe nivelë (nëse është e mundur)
- ☐ Busulla orientuese. Ekzistojnë edhe aplikacione telefonike të shkarkueshme, që kryejnë funksionin e busullës.
- ☐ Instrument matës i gjerësisë së çarjes
- ☐ Metër lazer për matje largësisë
- ☐ Karta si shkallë referimi për fotografitë
- ☐ Dosje mbështetëse me kapëse për fletët
- ☐ Letër – e bardhë dhe e milimetruar
- ☐ Lapsa plumbi dhe lapsa me ngjyra, për të shënuar detajet te hartat. Shmangni stilolapsat, pasi boja do të përhapet nëse formatet lagen dhe do të humbni informacionin bazë.
- ☐ Goma, mprehëse lapsash dhe vizore
- ☐ Makinë llogaritëse (nëse është e mundur)
- ☐ Shiritë, litarë dhe sinjalistikën përkatëse
- ☐ Ujë në shishe dhe ushqim
- ☐ Lista telefonash të personelit kryesor të situatave emergjente, p.sh., policia, stacioni zjarrfikës, ambulanca etj.



BC Housing. 2018. *Rapid Damage Assessment*. Burnaby, BC Housing. Burnaby, BC Housing.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/686P-5JFE>

Lista e kontrollit të pajisjeve mbrojtëse personale

Në varësi të llojit të emergjencës dhe të sitit që po dokumentoni, pajisjet e mëposhtme duhet të merren para mbërritjes në vend, për të garantuar sigurinë personale të të gjithë anëtarëve të ekipit:

- ☐ Kaskë
- ☐ Xhaketë ose jelek sigurie
- ☐ Pantallona të gjata dhe këmbishë me mëngë të gjata
- ☐ Këpucë të mbyllura
- ☐ Elektrik dore ose fener me bateri rezervë
- ☐ Bilbil
- ☐ Maska me filtër kundër pluhurit
- ☐ Doreza sigurie
- ☐ Syze mbrojtëse
- ☐ Kuti personale e ndihmës së shpejtë
- ☐ Ilaç kundër insekteve (nëse është e mundur)
- ☐ Dezinfektues duarsh (nëse është e mundur)



Connecticut Technology Transfer Center. 2010. *Protective Equipment for Workers in Hurricane Flood Response*. Connecticut, School of Engineering, University of Connecticut.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/LG2T-FTDZ>

Heritage Collections Council. 1998. *reCollections: Caring for Collections Across Australia — Managing People*. Canberra, Heritage Collections Council.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/RR45-BJDW>

Si të vizatoni planimetrinë e një siti

Planimetritë e sitit janë të dobishme për vlerësimin dhe për dokumentimin e dëmit. Në rast se nuk e keni një të tillë, mund të **skiconi** një plan, duke ndjekur këta hapa:



- 1 Ecni përreth sitit të prekur për të krijuar një ide mbi përmasat e tij, të boshtit të simetrisë dhe të formës, në mënyrë që të **zgjidhni shkallën** e vizatimit tuaj. Kur të përcaktoni shkallën e vizatimit, merrni gjithashtu parasysh përfshirjen në hartë të elementeve fqinje, si monumentet më të rëndësishme, zonat e rrezikut etj.
- 2 **Zgjidhni një pikë fillestare** (për shembull, një cep të strukturës) dhe shënojeni atë në letër milimetrike.
- 3 Tani mund të **filloni të lëvizni rreth objektit dhe të vizatoni planimetrinë** mur pas muri. Nuk keni nevojë të jeni shumë i saktë kur hartoni planimetrinë, pasi nuk duhet t'i afroheni shumë afër strukturës së dëmtuar në këtë fazë të vlerësimit. Nëse nuk keni mjete matëse, mund të përdorni hapin tuaj si njësi të përafërt: një gjatësi hapi është e barabartë me afërsisht një metër.
- 4 Shënoni **shkallën dhe drejtimin e zgjedhur të referencës** (p.sh., drejtimin e veriut ose të Kiblës) në hartë.
- 5 Tregoni **rrugët e përdorshme** dhe **hyrjet** kryesore të ndërtesës ose sitit. Shënoni **zonat e sigurta** të identifikuara (nëse ka) që mund të përdoren më vonë për stabilizimin emergjent dhe për magazinimin, ose për të parkuar një makinë në rast evakuimi.
- 6 Mos harroni të shënoni **elementet përreth** që mund të rrezikojnë ndërtesën nëse shemben.
- 7 Në rast të shembjes totale, angazhoni njerëz që punojnë ose që jetojnë në sit. Ata mund të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë me udhëzime, nëse të gjitha pikat e tjera të referencës nuk janë të disponueshme.




Sigurohuni që të keni shënuar dëmtimet dhe vrojtimitet e tjera në planimetrinë e sitit, në mënyrë që të mund t'i lexoni përsëri në një fotografi të planimetrisë.

1-A

PLAN I NDERTHUR I ZONIMIT DHE SIGURISË

PLANIFIKIMI PËR MENAXHIMIN E RISKUT PËR PALLATIN E QYTETIT, UDAIPUR



PLAN 1-A
ZONIMI NGA QËNDROJA
KONTROLLIMI NGA RËZIKU

Shembulli i hartës së sitit të Pallatit të Qytetit, Udaipur, Indi, 2009. Foto: Rohit Jigyasu.

Si të krijoni një hartë bazë

Kur në një zonë preken site të shumta, është e nevojshme një hartë bazë. Nëse nuk ka një hartë bazë të zonës së prekur, mund të përgatitet shpejt një e tillë, duke përdorur një pamje satelitore që tregon zonën / qytetin / rajonin, varësisht nga shkalla dhe nga natyra e situatës.

Harta bazë duhet të tregojë veriun, si dhe të tregojë strukturat përkatëse, rrugët dhe shtigjet e kalueshme dhe kufijtë e juridiksionit.

Nëse fatkeqësia ose kriza është e përhapur gjerësisht, duke prekur një rajon ose qytet të tërë, duhet të krijohet një hartë në shkallën e duhur, që tregon vendndodhjen e të gjitha siteve të prekura të trashëgimisë. Secilit sit duhet t'i jepet një numër unik identifikimi, që do të përdoret më vonë për vlerësimin e shpejtë.



Cilat janë karakteristikat më të rëndësishme për një formular të vlerësimit të dëmit dhe riskut pas ngjarjes?


- 1 **I saktë** dhe i thjeshtë për t'u plotësuar.
- 2 I përshtatur me **kontekstin** dhe **gjuhën vendase**.
- 3 **I standardizuar** dhe i përshtatshëm për trashëgiminë materiale të luajtshme, të paluajtshme si dhe atë jomateriale në zonën e prekur.

Diskutoni me ekipin mbi përkufizimin e secilës kategori të dëmit dhe riskut, në mënyrë që të dhënat e regjistruara të jenë të njëjta për të gjithë ekipin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ekipet e mëdha, ku grupe të shumta janë duke regjistruar të dhëna.

Edhe pse formularët mund të jenë specifikë për llojet e fatkeqësive dhe llojet e trashëgimisë kulturore, ata duhet të ndihmojnë në kryerjen e vlerësimeve të integruara të dëmeve dhe risqeve. Për shembull, nëse rreziku kryesor është një tërmet, duhet gjithashtu të merren parasysh (nëse është e mundur) edhe rreziqet që lidhen me të, si zjarri dhe reshjet e dendura të shiut.

Përfshini opsione me zgjedhje të shumëfishtë, me mundësinë për të shtuar të dhëna cilësore, aty ku është e nevojshme. Kur është e nevojshme, grumbulloni informacione në nivele të ndryshme, të cilat gjithashtu mund të jenë nëngrupe të njëra-tjetrës, si p.sh.:

- 1 Në nivel rajoni / qyteti / zone
- 2 Në nivel siti
- 3 Në nivel ndërtese
- 4 Në nivel koleksionesh / objektesh



Vlerësimi në vend dhe dokumentimi i dëmit dhe riskut për trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme



Formati 1

Formati i mëposhtëm përshkruan nivelet dhe fushat e mundshme të informacionit, që mund të merren parasysh kur krijohen formularë të veçantë ose të integruar të vlerësimit në vend të dëmit dhe riskut për trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme.



Për të kursyer kohë, disa nga pikat e renditura të informacionit, si emri, rëndësia ose pronësia, mund të plotësohen jashtë sitit.

Do t'ju duhet të përshtatni informacionin e dhënë për të përfshirë materiale dhe teknika tipike ndrtimore që mbizotërojnë në objekte të trashëgimisë në zonën tuaj.

Veç kësaj, meqenëse nuk ka dy emergjenca të ngjashme, jo i gjithë informacioni i dhënë në këtë format mund të jetë i përshtatshëm për efektet e një fatkeqësie me të cilën po përballeni. Për shembull, nëse në një situatë të caktuar ndërtesat e trashëgimisë janë dëmtuar dhe objektet brenda janë të paprekura, ju mund ta përdorni këtë format për të hartuar një formular vlerësimi për ndërtesat e trashëgimisë dhe të përfshini vetëm nivelet dhe fushat më të rëndësishme të informacionit.

Nëse vendosni të përgatitni formularë të integruar të vlerësimit të dëmit dhe risqeve, sigurohuni që ekipet që do të përdorin formularë të tillë të jenë të disiplinave të ndryshme si dhe t'u jetë dhënë trajnim paraprak për të njohur dëmin dhe risqet për trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme.

- 1 Data(t) e vlerësimit.
- 2 Emri(at) e vlerësuesit(ve).
- 3 Detaje kontakti të vlerësuesit(ve).
- 4 Profesionin e vlerësuesit(ve) aty ku është e nevojshme.

Niveli 1. Rajoni / qyteti / zona (i përshtatshëm në rastin e një fatkeqësie në të gjithë rajonin)

- 1 Emri i qytetit / zonës dhe gjeo-koordinatat e tij.
- 2 Përshkrimi i ngjarjes.

- 3 Natyra e rrezikut fillestar (p.sh., natyrore ose e shkaktuar nga njeriu).

Fatkeqësi natyrore: tërmet, uragan, stuhi rëre, përmbytje, zjarr etj.

Fatkeqësi të shkaktuara nga njeriu: vandalizmi, zjarrvëniet rrezatim bërthamor, lufta / aktivitete ushtarake etj.

Niveli 2. Zona (veçanërisht e rëndësishme nëse zona e prekur përfshin site arkeologjike dhe lloje të tjera të siteve të trashëgimisë kulturore që përmbajnë elemente të ndryshme materiale dhe jomateriale)

- 1 Emri i sitit.
- 2 Vendndodhja dhe koordinatat e sitit.
- 3 Kur është e nevojshme, përdorni një hartë bazë të sitit ku keni shënuar vendndodhjen e elementeve si shtojcë e formularit të vlerësimit.
- 4 Niveli i mbrojtjes (p.sh., ndërkombëtar, kombëtar, lokal ose i pambrojtur)?
- 5 Cila është shkalla e dëmtimit (p.sh., e vogël, e mesme ose e rëndë) në sit? Ku gjendet dëmi?
- 6 A ka inerte të jashtme dhe mbetje toksike në sit që duhet të pastrohen?
- 7 A ka siti hapësira të sigurta dhe të lira pune për zhvillimin e operacioneve të sigurimit dhe stabilizimit? Shënoni vendndodhjen e tyre në hartën e sitit. Gjithashtu, nëse ka, emërtoni vendparkimet e disponueshme për automjete të mesme dhe të rënda në sit ose pranë tij.
- 8 Regjistroni humbjet.

Kur është e mundur dhe kur të dhënat janë të disponueshme, regjistroni humbjet sa u përket të ardhurave, njerëzve dhe / ose infrastrukturës. Disa aspekte për t'u marrë parasysh:

- Numri i stafit para dhe pas ngjarjes.
- Aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me të ardhurat, p.sh., shitës suvenieresh, industri artizanale, biznese të lidhura me turizmin / mikpritjen.
- Numri mesatar i vizitorëve para dhe pas ngjarjes.

Niveli 3. Ndërtesa

Shënim: pyetjet dhe rekomandimet e renditura më poshtë janë krijuar për të ndihmuar gjatë vlerësimit të një ndërtese të vetme.



- 1 a Emri i ndërtesës?
b Cili është numri i inventarit të ndërtesës (nëse ekziston tashmë)?
c Nëse numri i inventarit të ndërtesës nuk dihet, caktoni një numër referimi për ndërtesën.
- 2 Pronësia e ndërtesës (publike, private ose e panjohur)?
- 3 Për çfarë përdoret aktualisht, p.sh., a është një ndërtesë biznesi, fetare apo publike (monument, bibliotekë, muze, shkollë etj.)?
- 4 Cili është niveli i vazhdimësisë së funksionit: pa ndërprerje / ndërprerje totale / ndërprerje në një pjesë të ndërtesës por vazhdon diku tjetër?
- 5 Përveç formularit, a keni grumbulluar materialin që vijon: një hartë të sitit, foto para ngjarjes, vizatime dhe skica të ndërtesës?
- 6 Niveli i mbrojtjes: ndërkombëtar / kombëtar / lokal / i pambrojtur?
- 7 Informacion i përgjithshëm në lidhje me ndërtesën:
 - a A ekzistojnë të dhënat e mëparshme të ndërtesës (p.sh., planimetria, pamje, prerje apo të dhëna mbi ndërhyrjet e mëparshme)?
 - b Nëse po, ku gjenden / kush i disponon të dhënat?
 - c A tregon dokumentacioni i mëparshëm rëndësinë (estetike, historike, kulturore, fetare, shkencore dhe / ose ekonomike) të ndërtesës së dëmtuar?
 - d Në rast se ndërtesa paraqet rëndësi shpirtërore, fetare ose rëndësi të një natyre tjetër jomateriale, a nevojiten trajtime, praktika ose veprime specifike? Nëse po, ju lutemi të tregoni cilat veprime janë të nevojshme dhe ku mund të gjenden personat specifik (udhëheqësit fetarë, personat e vjetër të komunitetit etj.) që mund t'i kryejnë ato veprime?
- 8 Cili është niveli i dëmit: shembje e vogël, mesatare, e rëndë apo e plotë?



- 9 Cilat materiale ndërtimore janë përdorur në ndërtesë, çfarë sistemi konstruksioni është përdorur për ta ndërtuar atë dhe ku ka pësuar dëmtim ndërtesa (p.sh., muret, çatia, dyshemeja ose elementet strukturore)?

I Muri

II Çatia

III Materiali i dyshemesë

IV Elementet strukturore

- 10 Përshkruani dëmin kritik jostrukturor që ka pësuar ndërtesa dhe shënojeni dëmin në planimetrinë e ndërtesës.

Bëni fotografi të llojeve të ndryshme të dëmtimit; shënoni numrat përkatës të fotografive në planimetri.

- 11 Renditni risqet e menjëhershme:

Rrezik parësor	Rrezik Dytësor	Risk i menjëhershëm (ndikimi i mundshëm në vlerat e trashëgimisë / sigurisë)	Faktorët e cenueshmërisë (shkaqet themelore)
Tërmet	Pasgoditjet e tërmetit, zjarri	Elementet prej druri të ndërtesës së shekullit të 18-të mund të marrin flakë; njerëzit e shpërngulur që jetojnë afër ndërtesës mund të humbin jetën.	Instalime elektrike jo të mirëmbajtura; njerëzit e shpërngulur që jetojnë afër ndërtesës përdorin energji elektrike dhe gaz

- 12 A ka hapësira të sigurt pune pranë ndërtesave të prekura, të cilat mund të përdoren për të kryer stabilizimin emergjent të ndërtesës dhe ruajtjen e objekteve me vlerë dhe / ose mjeteve?
- 13 A është i nevojshëm pastrimi i sitit nga inertet?
- 14 A ka ndonjë hapësirë në dispozicion për parkimin e automjeteve të mesme dhe të rënda pranë ndërtesave të prekura?



- 15** Renditni veprimet e menjëhershme që duhet të ndërmerren për të siguruar dhe për të stabilizuar ndërtesën. Nëse është e mundur, siguroni gjithashtu kosto për veprimet, në konsultim me përgjegjësit dhe ekspertët vendas.



Niveli 4. Objektet / koleksionet

- 1** Ku ndodhen objektet / koleksionet në ndërtesë? Shënoni numrat e katit dhe të dhomës.
- 2** A janë objektet në vendet e tyre origjinale ose në ato të para ngjarjes? Nëse jo, shënoni vendndodhjen e re në një planimetri kati ose në hartën e sitit.
- 3** Informacion i përgjithshëm në lidhje me koleksionin:
 - a** A ekzistojnë të dhënat e mëparshme të koleksionit (p.sh., inventarët, regjistri i pranimit, katalogët)? Nëse po, ku gjenden ato / kush i ka të dhënat?
 - b** A tregon dokumentacioni i mëparshëm rëndësinë (estetike, historike, kulturore, fetare, shkencore dhe ekonomike) të objekteve të dëmtuara?
 - c** Në rast se objektet paraqesin rëndësi shpirtërore, fetare ose rëndësi të një natyre tjetër jomateriale, a kërkohen trajtime, praktika ose veprime specifike? Nëse po, ju lutemi të tregoni cilat veprime kërkohen dhe ku mund të gjenden personat specifikë (udhëheqësit fetarë, personat e vjetër të komunitetit etj.) që mund t'i kryejnë ato veprime?
- 4** Regjistroni llojet e objekteve të dëmtuara. Shembujt mund të përfshijnë: piktura, monedha, libra, dorëshkrime, dokumente, fotografi, materiale audio dhe video, afreskë, mozaikë, skulptura etj.
- 5** Sa objekte mendoni që mund të ketë? Nëse objektet janë grumbulluar njëri mbi tjetrin dhe është e vështirë të vlerësosh sasinë e tyre, merrni dimensionet e grumbullit (lartësia, gjatësia dhe gjerësia); bëni një foto dhe shënoni numrin e referencës së fotos në formular dhe në planimetrinë e katit ose në hartën e sitit.

6 a Regjistroni llojin e dëmit:

- Lagie
- Djegie
- Deformime
- Thyerje
- Shqyerje
- Çarje
- Myk
- Insekte
- Ndotje
- Tym
- Kimikate
- Tjetër (shpjego)

b Tregoni nivelin e dëmit.

Niveli 1 (i vogël): dëmtimi i objektit nuk shtohet kur objekti mbahet në dorë (objekti mund të zhvendoset dhe nuk kërkon trajtim të kujdesshëm).

Niveli 2 (mesatar): dëmtimi i objektit nuk shtohet kur ai mbahet dhe trajtohet me qetësi dhe kujdes. Sidoqoftë, nëse objekti i nënshtrohet një lloj trajtimi të vrazhdë, ka shumë mundësi që dëmi të përkeqësohet.

Niveli 3 (i rëndë): edhe trajtimi i kujdesshëm dhe i saktë i objektit do të rezultojë në përkeqësimin e dëmit ekzistues.

Bëni foto të llojeve të ndryshme të dëmtimit; shënoni numrat e referencës të fotografive në planimentrinë e katit.

7 Renditni risqet e menjëhershme ndaj objekteve / koleksioneve:

Rrezik parësor	Rrezik dytësor	Risk i menjëhershëm (ndikimi i mundshëm në vlerat e trashëgimisë/sigurisë)	Faktorët e cenueshmërisë (shkaqet themelore)
Përmbytje	Myk	Objektet organike në katin përdhe dhe bodrum do të preken: myku në ndërtesë paraqet kërcënim për stafin dhe përgjegjësit e objekteve/koleksioneve.	Hyrja kryesore në sit është e dëmtuar: ndërtesa është bllokuar: dritaret nuk mund të hapen dhe nuk ka energji elektrike.



- 8 A ka aty afër hapësira të sigurta dhe të disponueshme, të cilat mund të shërbejnë për stabilizimin ose magazinimin e objekteve?
- 9 A ka një vend parkimi të disponueshëm për automjete të mesme ose të rënda në vendndodhje, ose pranë sitit që ka objektet e prekura?
- 10 Renditni veprimet e menjëhershme që duhet të ndërmerren për të siguruar dhe stabilizuar koleksionet / objektet. Nëse është e mundur, llogaritni me përafërsi edhe kostot për ndërhyrjet, në konsultim me përgjegjësit dhe ekspertët vendas.



Vlerësimi në vend dhe regjistrimi i dëmeve dhe risqeve për trashëgiminë kulturore jomateriale

Formati 2

Formati i mëposhtëm përshkruan nivelet dhe fushat e mundshme të informacionit, që duhet të merren parasysh kur krijoni një formular për të kryer vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut për trashëgiminë kulturore jomateriale. Ndoshta do të duhet të përshtatni informacionin e dhënë për të përfshirë llojet tipike të trashëgimisë jomateriale të përhapur në zonën tuaj: kjo duhet të bëhet para një fatkeqësie. Sidoqoftë, meqenëse nuk ka dy emergjenca të ngjashme, këto formate mund të kenë nevojë të përshtaten me natyrën e rrezikut të fatkeqësisë me të cilën po përballeni dhe efektet e saj në trashëgiminë kulturore jomateriale.

- 1 Data(t) e vlerësimit.
- 2 Emrat e vlerësuesve.
- 3 Të dhënat e kontaktit për vlerësuesit.

Niveli 1. Rajoni / qyteti / zona

- 1 Emri i qytetit / zonës dhe gjeo-koordinatat e tij.
- 2 Përshkrimi i ngjarjes.
- 3 Natyra e rrezikut fillestar (p.sh., natyrore ose e shkaktuar nga njeriu).

Fatkeqësi natyrore: tërmet, uragan, stuhi rëre, përmbytje, zjarr etj.

Fatkeqësi të shkaktuara nga njeriu: vandalizmi, zjarrvëniet, rrezatimi bërthamor, lufta / aktiviteti ushtarak etj.
- 4 Vendndodhja e sitit, me koordinata (kur është e nevojshme).
- 5 Harta kryesore e sitit me vendndodhjen e elementeve përbërëse (kur është e nevojshme).

Niveli 2. Fenomeni



- 1 Emri / përshkrimi i fenomenit
- 2 Lloji i fenomenit:
 - a. Traditat dhe shprehjet gojore, përfshirë gjuhën
 - b. Artet skenike
 - c. Praktikrat shoqërore, ritualet dhe ngjarjet festive
 - d. Njohuri dhe praktika në lidhje me natyrën dhe universin
 - e. Mjeshtëri artizanale tradicionale

Llojet e elementeve të renditura më sipër janë në përputhje me Konventën e UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë Jomateriale të vitit 2003. Kur nuk është e lehtë të bëhet dallimi midis këtyre kategorive, rekomandohet që, pas një emergjence, ekipet të bien dakord mbi interpretimin e kategorive dhe të realizojnë në përputhje me rrethanat grupimin e trashëgimisë kulturore jomateriale që është prekur. Qëllimi kryesor i përcaktimit të llojit të fenomenit në fjalë është të kuptohet sa më mirë se cilat lloje të trashëgimisë kulturore jomateriale janë (më) të prekura. Nëse është e përshtatshme, ekipet mund të duan t'i zëvendësojnë këto kategori me terma më praktikë lokalë (p.sh., festivale, valle me maska, muzikë, rituale fetare).

- 3 Niveli i mbrojtjes: ndërkombëtar / kombëtar / lokal / i pambrojtur?
- 4 Në rastin e industrive kulturore, artizanale etj., ju lutemi të tregoni se cilat nga këto janë prekur:
 - a. Lënda e parë
 - b. Hapësira e prodhimit, makineritë, mjetet, rezervat e produkteve ose materialit
 - c. Stafi, fuqia punëtore e kualifikuar
 - d. Tregjet (shitjet dhe klientët)
 - e. Transmetimi i mjeshtërive



5 Përshkrimi i efekteve:

Përshkruani se si është prekur trashëgimia për secilin nga tri nivelet. Ju lutemi të merrni parasysh edhe elementet e qasjes, të transmetimit dhe të vazhdimësisë afatgjatë të trashëgimisë jomateriale.

a. Trashëgimia materiale: i vogël / mesatar / i rëndë?

b. Njerëzit: i vogël / mesatar / i rëndë?

c. Njohuritë dhe traditat: i vogël / mesatar / i rëndë?

Shënim për “nivelet e dëmtimit”. Shkalla në të cilën një element është prekur (i vogël, mesatar ose i rëndë) do të varet nga situata specifike. Kur është e mundur, krahasojeni nivelin e ashpërsisë së efekteve në raste të ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale të të njëjtit lloj (p.sh., festivale të ndryshme) ose të trashëgimisë kulturore jomateriale të llojeve të ndryshme (festa, praktika fetare, zeje etj.) Metodologjia duhet të miratohet nga ekipi i vlerësimit përpara se të ndërmarrë vlerësimin dhe mund të rregullohet më tej pas vlerësimit, në diskutim me të gjithë ekipin. Qëllimi kryesor i vlerësimit të niveleve të dëmtimit është të kuptohet sa më mirë se cilat lloje të trashëgimisë kulturore jomateriale ose cilat elemente specifike të trashëgimisë kulturore jomateriale janë prekur më rëndë se të tjerët.

6 Cili është niveli i vazhdimësisë së funksionit: pa ndërprerje / ndërprerje totale / ndërprerje në një pjesë të sitit, por vazhdon në pjesë të tjera?

7 Përshkruani se si efektet në elementin e trashëgimisë po ndikojnë në komunitet:

Kur është e mundur (kur të dhënat janë të disponueshme ose mund të vlerësohen), ju lutemi shtoni një numër ose përqindje të njerëzve / familjeve (përfshini kategorinë përkatëse) që janë prekur:

a. Drejtpërdrejt?

b. Jo drejtpërdrejt?





- 8 Cilat risqe dytësore mund të ndikojnë në elementin e trashëgimisë kulturore? Listojini ato dhe shpjegoni ndikimin që mund të kenë.

Rrezik Parësor	Rrezik dytësor	Risk i Menjëhershëm (ndikim i mundshëm në vlerat e trashëgimisë / sigurisë)	Faktorët e cenueshmërisë (shkaqet themelore)
Tërmet	Pasgoditjet e tërmetit, zjarr	Jetët e praktikuesve në rrezik: aktiviteti mund të jetë ndërprerë për shkak të trazirave shoqërore.	Strehim i papërshtatshëm: mungesë siguracioni ose dëmshpërblimi.





Këshilla për mbledhjen e të dhënave për dëmet

- Vetëm dëmi kryesor duhet të dokumentohet gjatë fazës së emergjencës. Nuk duhet humbur kohë duke dokumentuar procese të ngadalta dhe progresive të përkeqësimit dhe risqeve: këto mund të presin derisa situata të jetë e përshtatshme për kryerjen e vlerësimeve të hollësishme.
- Kur vlerësoni dëmet dhe risqet ndaj trashëgimisë jomateriale, mund të filloni duke vlerësuar elementet materiale të lidhura me to (ndërtesat, mjetet, kostumet etj.) dhe njerëzit. Për shembull, nëse është ndikuar artizanati, vlerësoni dëmin e produkteve artizanale, të pajisjeve dhe të mjeteve të përdorura, të lëndëve të para të nevojshme dhe të punishteve. Në të njëjtën kohë, përpikuni të kuptoni se çfarë ndikimi kanë pasur vetë artizanët.
- Shmangni shkrepjen e shumë fotografive të të njëjtit dëm ose vendndodhjeje, pasi kjo ndërlikon përpilimin e të dhënave. Në vend të kësaj, sigurohuni që të keni disa fotografi me pamje të gjerë dhe me cilësi të mirë, dhe kur duhet, bëni fotografi të hollësishme (foto në detal).
- Grumbulloni të dhëna sa më objektive, bazuar në vëzhgimet dhe intervistat.
- Mundohuni të mos bëni interpretime ose analiza nëse nuk i keni kualifikimet e duhura për ta bërë këtë.
- Jini të përpiktë në mënyrën se si i grumbulloni të dhënat dhe përmbledhni këto të dhëna në një format që mund të riprodhohet lehtësisht. Kombinojini këto të dhëna me intervistat.
- Sigurohuni që të keni mbledhur më shumë sesa thjesht numra. Gjithashtu është e rëndësishme të komunikoni me njerëzit – veçanërisht me grupet e interesit, si administratorët e sitit, komunitetet dhe autoritetet lokale.
- Të dhënat duhet të lexohen dhe të interpretohen lehtë.
- Kontrolloni me kujdes: informacioni i vlefshëm mund të fshihet në inertet e krijuara si pasojë e shkatërrimeve.





- Që të mos humbasin të dhënat, grumbullojini ato përmes mjeteve të shumta, si për shmebull: formularë vlerësimi, shënime të shkruara, skica, fotografi dhe mjete teknologjike.
- Të dhënat mbi dëmin në trashëgiminë kulturore shpesh mund të jenë (të ndjeshme) dhe ndonjëherë mund të jenë dhe burim konflikti. Merrni masa që të siguronin të dhënat e mbledhura (p.sh., duke përdorur një “hard disk” të jashtëm “HDD” të enkriptuar), të cilin e dorëzoni vetëm pranë autoriteteve.



Dëmi tipik strukturor dhe jostrukturor që i është shkaktuar ndërtesave dhe strukturave

Më poshtë janë listuar disa dëme tipike strukturore dhe jostrukturore të shkaktuara te ndërtesat dhe strukturat e trashëgimisë si pasojë e fatkeqësive të ndryshme, si tërmete, uragane, zjarre dhe përmbytje.

Ky shënim rendit format tipike të dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë e ndryshme në llojet e mëposhtme të strukturave dhe materialeve. Megjithatë, nuk është një listë shteruese. Kini parasysh që dëmet tipike të evidentuara për një tipologji ndërtimi të caktuar mund të ndodhin edhe në tipe të tjera ndërtimesh. Kjo gjë varet edhe nga itinerari që ndjek fatkeqësia. Për shembull, dëmtimi nga zjarri në një ndërtesë varet nga vendi ku ndodh zjarri:

- **konstruktion murature** prej guri me mure mbajtëse dhe çati me dy pjerrësi;
- **një strukturë me skelet druri**;
- **një strukturë prej qerpiçi** me mure mbajtëse, qemerë dhe kupola.




Strukturat e dëmtuara të objekteve të trashëgimisë që qëndrojnë në këmbë mund të shemben në çdo kohë. Prandaj, kërkon ndihmën e një inxhinieri konstruktor ose një arkitekti që ka njohuri për mekanizmat e shembjes në ndërtesat e trashëgimisë dhe llojet e ndërtimit në zonën tuaj.



Strukturë murature prej guri me mure mbajtëse, me skelet druri dhe çati me dy pjerrësi



Rrezik: tërmeti, uragani



- 1** Dëmtimi në lidhjen midis strukturave vertikale dhe horizontale: zhvendosja e çatisë dhe / ose murit mund të dobësojë lidhjet midis dy strukturave, duke shkaktuar çarje në muraturë.
- 2** Dëmtimi i çatisë / kulmit: kjo ndodh kur tjegullat, petavrat ose materialet e tjera të mbulimit nuk janë të lidhura mirë dhe nuk mund t'i rezistojnë erërave të forta, siç janë ato të shkaktuara nga uragani. Në raste ekstreme, mbulesën e çatisë mund ta marrë era.
- 3** Epja e faqeve të murit (barkëzim): kur dy faqe të një muri nuk janë të lidhura mirë, faqet e murit do të krijojnë epje, kur u nënshtrohen forcave horizontale jashtë planit.
- 4** Çarjet diagonale: këto janë çarje tipike të shkaktuara nga rezistenca e dobët e muraturës ndaj sforcimeve prerëse si rezultat i forcave horizontale brenda planit. Këto çarje ndodhin zakonisht në pjesët më pak rezistente të një muri, siç janë hapjet e dritareve apo dyerve.
- 5** Përkulja e muraturës: kur ekstremitetet e një muri janë të lidhura mirë me strukturat horizontale, muri mund të pësojë përkulje për shkak të veprimit të forcave horizontale anësore jashtë planit.


- 6 Çarjet këndore: këto krijohen nga përqendrimi i sforcimeve, të shkaktuara nga ndryshimi i ngurtësisë midis krahëve të një ndërtese në formë L-je, T-je ose C-je, kur i nënshtrohen një force anësore horizontale.
- 7 Shkëputja e fasadës nga muret tërthore: kjo formë e dëmtimit evidentohet nga çarje në këndet e ndërtesës, të cilat shfaqen në secilin kat dhe zmadhohen nga poshtë drejt kulmit të ndërtesës, ose shfaqen si çarje midis mureve të brendshme dhe dysHEMEVE pranë fasadës.
- 8 Shembja e një frontoni: një mur që përfundon me fronton ka një raport shumë të madh mes lartësisë dhe trashësisë së murit dhe zakonisht lidhja e këtij muri me çatinë është e dobët. Mure të tilla rrëzohen lehtë kur u nënshtrohen forcave horizontale jashtë planit.
- 9 Dyert që dalin nga menteshat e tyre: dyert prej druri ose kanatet mund të dalin nga menteshat e tyre, veçanërisht nëse ato janë të hapura në kohën gjatë fatkeqësisë.
- 10 Shembja e katit të ashtuquajtur “kat i butë”: kur niveli ose kati i një ndërtese ka ngurtësi të ndryshme krahasuar me nivelin ose katin më sipër, për shembull, kur ka hapje të mëdha në fasadën e tij, ai mund të shembet lehtë nën trysninë e forcave horizontale.



Struktura qerpiçi me mure mbajtëse, qemere dhe kupola



Rreziqe: tërmeti, uragani




- 1 Rënia e pjesshme e harkut: ngritja e nivelit të harkut mund të shkaktojë zhvendosjen e elementeve kyç dhe të prishë vazhdimësinë e harkut. Elementet e mbetura të harkut, duke qenë konsol, mund të shemben lehtë. Ky fenomen është edhe më i rrezikshëm, pasi harqet shpesh veprojnë edhe si struktura mbështetëse për elemente të tjera.
- 2 Çarje të lehta vertikale në bazën e një kupole: për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të ngjarjes së fatkeqësisë, gjatë të cilës rriten forcat tërheqëse: këto çarje nuk janë të rrezikshme, për sa kohë që muret mbajtëse janë të qëndrueshëm. Kupolat zakonisht janë shumë rezistente ndaj forcave horizontale.
- 3 Rënia e kontrafortit: nëse lidhja midis murit dhe kontrafortit është e dobët, kontraforti do të shembet dhe nuk do të parandalojë përmbysjen e murit.
- 4 Çarje diagonale pa shkëputje: këto çarje dobësojnë strukturën, por nuk janë të rrezikshme për sa kohë që nuk ka shkëputje midis elementeve mbajtëse të muraturës.
- 5 Çarje e lehtë gjatësore e qemerit: çarje të tilla dobësojnë qemerin, por për qemerin nuk përbëjnë rrezik për shembje të menjëhershme, për sa kohë që muret mbajtëse ose qemerët pranë tij janë në gjendje të qëndrueshme.

- 6 Çarje në qemer: shembja e murit mbajtës shkakton sforcime të strukturës, të cilat sjellin çarje gjatësore në qemer dhe rrjedhimisht shembjen e tij. Bodrumet me qemer zakonisht janë shumë rezistente ndaj forcave horizontale, pasi muret e tyre mbajtës janë të fortë.
- 7 Rënia e trarëve të çatisë: kur një mur mbajtës del nga vertikalet me drejtim për jashtë, trarët e çatisë që mbështeten në mur mund të bien dhe të shemben, pasi zvogëlohet sipërfaqja e murit mbi të cilën mbështeten trarët. Kjo përkthehet në humbjen e mbështetjes për trarët e çatisë.
- 8 Çarje horizontale: këto shfaqen në zonën e bashkimit midis materialeve me karakteristika të ndryshme. Ato nuk janë shqetësuese nëse një pjesë e murit nuk shfaq lëvizje jashtë planit.



Struktura me skelet druri

Rreziqe: tërmeti, uragani




- 1 Shkulja e çatisë / kulmit: kur erërat e forta godasin një fasadë, ato mund ta shkulin çatinë. Mbulimet e verandave janë veçanërisht të cenueshme, pasi sipërfaqja e çatisë e ekspozuar ndaj erërave është më e madhe. Elementët e mbulimit të palidhura shndërrohen në predha të rrezikshme dhe boshllëqet që ato lënë pas, lejojnë depërtimin e ujit në ndërtesë.
- 2 Shembja e oxhakut: oxhaqet janë veçanërisht të cenueshëm ndaj forcave horizontale madhore, duke pasur parasysh madhësinë, formën, pozicionin dhe numrin e tyre. Kjo lloj shembjeje mund të ndodhë edhe në një strukturë me mure prej guri.
- 3 Rënia e murit mbushës: nëse muret mbushëse janë të lidhura mirë me strukturën, ato nuk duhet të ndikohen nga forcat horizontale. Sidoqoftë, muri mbushës do të shembet lehtë nëse nuk është i lidhur mirë me strukturën kryesore.
- 4 Predha materiale: stuhitë e forta dhe shpërthimet e bombave shkaktojnë thyerjen dhe lëvizjen e elementeve (veçanërisht xhama, dyer dhe dritare); duke e shndërruar ato në objekte goditëse të rrezikshme.
- 5 Lëvizja e themelit si shkak i lëngëzimit të terrenit: është një fenomen gjatë të cilit forca dhe ngurtësia e tokave të ngopura zvogëlohet shumë për shkak të lëkundjeve nga tërmeti. Toka nuk është më në gjendje të mbajë themelet e ndërtesës dhe mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme.
- 6 Shkulja e një shtese ose aneksi të një objekti: forcat e mëdha horizontale mund ta shkulin një ndërtesë nga themelet, sidomos kur kjo ndërtesë është e ngritur mbi një mur të dobët.
- 7 Shembja e elementeve të larta përreth ndërtesës: pemët ose shtyllat në afërsi të një ndërtese me vlera të trashëgimisë kulturore mund të bien mbi ndërtesë, duke shkaktuar dëme në çati ose pjesë të tjera.



Strukturë me muraturë guri me mure mbajtëse, me skelet druri, me çati me dy pjerrësi.



Rreziqe: përmytja, zjarri



- 1 Shembja e çatisë: zjarri bën që druri të humbasë rezistencën e tij. Nëse struktura prej druri dëmtohet, çatia shembet dhe gjithashtu mund të tërheqë pas vetes dhe atë pjesë të murit në të cilin mbështetej.
- 2 Shembja e arkitraut prej hekuri ose çeliku: arkitrarët prej hekuri dhe çeliku fillojnë të humbin aftësinë mbajtëse kur ekspozohen ndaj nxehtësisë (300° C). Në rastin e ngarkesave të mëdha, për shembull, kur këto shërbejnë si arkitra, ato do të shformohen dhe nuk do të jenë më në gjendje të përmbushin rolin e tyre strukturor. Kjo mund të çojë në shembje të pjesshme të muraturës mbi arkitraun.
- 3 Shembja e arkitrarëve prej druri: muret mbi arkitrarët prej druri do të ngadalësojnë shkallën e djegies së drurit dhe kjo mund të lejojë që druri të ruhet mjaftueshëm sa për t'i bërë ballë rëndesës. Nëse jo, mund të rezultojë në shembjen e pjesshme të muraturës mbi arkitraun e drurit.
- 4 Rënia e mureve: nëse muret nuk janë më të lidhura me çatinë ose dyshemetë, ato mund të bien më lehtë dhe për këtë arsye duhet të konsiderohen të dobëta përballë veprimet të forcave horizontale.

- 5 Shembja e pjesshme për shkak të goditjeve nga inerte të rënda: pjesët e dobëta strukturore në qoshet e ndërtesës ka shumë të ngjarë të ndikohen nga goditjet e inerteve të rënda që bien mbi to ose nga rrjedhjet e furishme të ujit. Lidhjet midis mureve dobësohen dhe brezat lidhës duhet të restaurohen. Muratura e mbingarkuar duhet të përforcohet dhe puntelohet me pajanda.
- 6 Depozitimet e baltës: grumbullimi dhe depozitimet e baltës vonojnë tharjen e mureve dhe mund të krijojnë rrezik për shëndetin, pasi balta lehtëson rritjen e mykut dhe bakterieve. Balta ka të ngjarë të njollosë edhe muret prej guri. Prandaj duhet të hiqet sa më shpejt që të jetë e mundur.
- 7 Bymimi i trarëve prej hekuri dhe çeliku: në rast zjarri, trarët prej hekuri dhe çeliku priren të bymehen ndjeshëm. Ky zgjerim shkakton çarje në muraturat përreth dhe mund të rezultojë në përkuljen e mureve të holla. Nëse nuk janë të mbingarkuar, pas ftohjes, këta arkitrarë zakonisht kthehen në formën e tyre të mëparshme dhe rifitojnë pjesën më të madhe të forcës së tyre mbështetëse.
- 8 Zjarri dhe përmytja zakonisht dëmtojnë furnizimin me energji elektrike, ujë dhe gaz. Edhe nëse ky furnizim nuk ndërpritet, këshillohet t'i fikni të gjitha pajisjet e gazit dhe ato elektrike, pasi ato mund të jenë dëmtuar, dhe mos e përdorni ujin e rubinetit pasi mund të jetë i ndotur.







Strukturë qerpiçi me mure mbajtës, qemerë dhe kupola



Rreziqe: përmybtja, zjarri




- 1 Erozioni i suvasë: kjo ndodh kur suvatimi me baltë bie në kontakt me ujin.
- 2 Shembja e mureve të qerpiçit: kur njomet, balta humbet aftësinë e saj mbajtëse dhe mund të shembet. Muret prej balte do ta rimarrin aftësinë e tyre mbajtëse pasi të thahen, por mund të mbeten deformime dhe çarje të përhershme, që i dobësojnë muret.
- 3 Elementet prej druri të suvuara me baltë dhe / ose gëlqere: balta dhe gëlqerja janë rezistente ndaj zjarrit. Nëse shtresa e tyre është mjaftueshëm e trashë (~ 5 cm), këto lloje suvash parandalojnë që druri ose kashta të marrin flakë. Gjithashtu, meqenëse ato janë të përshkueshme, nuk e pengojnë tharjen e drurit ose të brendësisë të murit.
- 4 Çarjet e murit dhe të suvasë për shkak të tkurrjes: elementet e baltës dhe të gëlqeres kanë prirje të tkurren dhe të çahen kur përmbajtja e ujit në to ndryshon shumë shpejt. Kjo ndodh në rastet e ndryshimit ekstrem të temperaturës në një kohë të shkurtër. Aty ku punimi / dekorimi i suvasë është i rëndësishëm, bëni kujdes nga temperaturat e ftohta pas një zjarri. Në të njëjtën mënyrë, mos i thani ndërtesat pas përmybtjes, duke i mbinxhur.
- 5 Bymimi i baltës: vëllimi i argjilës rritet me përmbajtjen e ujit. Kjo mund të rezultojë në lëvizje të konsiderueshme të tokës dhe në ngritje të mureve. Pas tharjes mund të mbeten dëmtime të përhershme.
- 6 Dëmtimi i plintave të murit dhe i punimeve me suva: lagështia e tokës infiltron nëpërmjet bazamenteve të mureve dhe transportojnë kripëra që kristalizohen kur avullohet uji. Kristalizimi mund të formojë një shtresë pluhuri të bardhë në sipërfaqe dhe mund të shkaktojë shpërbërjen e elementeve të murit dhe të llaçit. Shtresat e papërshkueshme nga uji (siç tregohet nga vijat e kuqe) bëjnë që lagështia të rritet më shumë. Nëse lagështia nuk mund të avullojë, mund të dobësojë kohezionin e murit dhe muri mund të rrezikojë të shembet.
- 7 Uji i ndenjtur në qilar: qilarët zakonisht përmyben për një periudhë më të gjatë dhe kanë ventilim të dobët. Kjo çon në praninë e një lagështie të vazhdueshme dhe të problemeve të tjera që lidhen me lagështinë.



Struktura druri


Rrezik: përmbytja, zjarri



- 1** Shkatërrimi i elementeve të holla prej druri: elemente të holla druri që kanë funksione strukturore, për shembull, listela që përdoren për fiksimin e shtresës së mbulimit të çatisë, dyshemetë e drurit ose dërrasat e veshjes, digjen lehtë në rast zjarri.
- 2** Plasaritja e strukturës së drurit: kur bie zjarr, trarët e drurit fillojnë të digjen, shtresat e tyre të jashtme shndërrohen në qymyr dhe formojnë plasaritje, ndërkohë që sipërfaqja zhvillon një shtresë të trashë me ndërprerje. Kjo e mbron pjesën e brendshme të binarit nga dëmtimi. Strukturat tradicionale të drurit zakonisht janë me trarë / binarë të trashë. Pjesa e brendshme e binarit mund të vazhdojë të mbështesë peshën e çatisë, edhe nëse zjarri ka prekur sipërfaqen. Lidhjet midis trarëve (klapat) digjen më shpejt se vetë trarët, pasi ato kanë sipërfaqe me seksion më të vogël dhe përmbajnë elemente metalike.
- 3** Shtrembërimi i elementeve të holla prej druri: elementet e holla prej druri, si dyshemetë, dyert ose veshjet me dërrasa, mund të prishen ose mbufaten kur lagen. Ato rimarrin formën e tyre të mëparshme nëse nuk thahen shumë shpejt. Druri që thahet përgjatë disa javësh nuk ka gjasa të kalbet.
- 4** Dobësimi i dyshmeve prej druri: elementet prej druri rrezikojnë të dobësohen seriozisht në rastet kur qëndrojnë të mbuluara nga qilima të lagur dhe / ose balta për disa ditë rresht, ose më shumë.
- 5** Ngjeshja dhe pastrimi i thellë i baltës: kur uji i ardhur nga përmbytja tërhiqet, disa zona balte ngjishen, duke krijuar hapësira të çrregullta. Për më tepër, uji me rrjedhje të shpejtë mund të çojë në gërryerje të thellë, gjë që ekspozon ose gërryen themelet. Kjo do të shkaktojë dëme të mëdha në shtëpitë me struktura druri me themele jo dhe aq të thella ose të forta.
- 6** Shembja për shkak të forcës së ujit: mund të ndodhë nëse ndërtesa mbështetet në mur të gjymtuar të palidhur mirë me themele të forta.



SIGURIMI DHE STABILIZIMI



Si të vendosni rrjete kuadratike për të regjistruar vendndodhjet e objekteve dhe fragmenteve



- 1 Për të krijuar një rrjet kuadratik, së pari merrni parasysh madhësinë, formën dhe mundësinë e hyrjes në zonë, nga e cila duhet të merrni objektet ose fragmentet e ndërtesave historike. Duke vendosur një rrjet kuadratik ju mund të identifikoni vendndodhjen e saktë të secilit fragment, i cili ndihmon në integrimin e materialeve origjinale gjatë konservimit të plotë.
- 2 Në varësi të madhësisë së zonës që po përgatiteni të shpëtoni, krijoni rrjetën duke matur gjatësinë dhe gjerësinë e zonës dhe duke e ndarë atë në kuadrate me madhësi të barabartë. Në mënyrë që të hiqni fragmente ose tulla të mëdha të një strukture murature historike, mund ta ndani zonën që duhet të pastroni në sheshe 5 x 5 m.
- 3 Për të mbledhur materiale nga sipërfaqe të dekoruara dhe shumë të fragmentuara përdorni rrjete kuadratike më të vogla (shihni fotografinë).
- 4 Një rrjet kuadratik mund të krijohet me litarë të hollë dhe të sigurohet duke përdorur shufra të vogla prej metali ose druri. Përndryshe, përdorni gurë të rëndë për të fiksuar litarët në tokë. Sigurohuni që litarët të jenë shumë të dukshëm për të parandaluar pengimin dhe rrëzimin e personave.
- 5 Emërtojeni secilin katror në mënyrë alfanumerike dhe etiketojini ata duke përdorur etiketa ngjitëse dhe lapustilë që i rezistojnë ujit.




Rrjeti kuadratik për marrjen e fragmenteve të vogla të dekorimeve me 'stuko' (llaç) në një faltore në Bagan, Mianmar, 2016. Foto: ICCROM.

- 6** Pasi të keni krijuar rrjetin kuadratik, lokalizojini dhe shënojin ato në një hartë të katit. Sigurohuni që të tregoni një drejtim referimi (siç është veriu) dhe pikat kryesore të hyrjes në sit. Tregoni vendndodhjen e secilit rrjet, emrin e tij dhe kodin alfanumerik të qelizave.

A1	A2	A3
B1	B2	B3
C1	C2	C3

Një shembull se si të etiketoni një rrjet kuadratik në mënyrë alfanumerike:



Një shembull skice që tregon vendndodhjen e rrjeteve të ndryshme, Mianmar, 2016. Foto: E. Crété




Nëse një sit është përmblytur, ose kohën e keni të kufizuar, ndajeni sitin në seksione të gjera, si A, B ose 1, 2, dhe përcaktojini ato në një hartë të sitit që tregon veriu dhe jugun.

Si të krijoni kode të zhvendosjes në një depo të përkohshme

Një mënyrë e thjeshtë për të përgatitur një sistem të qëndrueshëm kodesh vendndodhjeje në një depo të përkohshme, e cila nuk ka mobilim, është të vizatoni një rrjetë kuadratike në dysheme me bojë, shirit ngjytës ose litarë.

Si fillim, ndajeni hapësirën e dyshemesë në kuadrate me një gjatësi të përshtatshme për çdo njësi, p.sh., 1 m x 1 m. Përdorni shkronja dhe numra për të bërë dallimin midis kolonave dhe reshtave. Përdorni etiketa në mur për t'i regjistruar ato.



E marrë nga: Tandon, A. 2016. *Endangered Heritage: Emergency Evacuation of Heritage Collections*. Paris, UNESCO & Rome, ICCROM.
E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/7J4C-TJDK>

Si të krijoni kodet e vendndodhjes dhe numrat e identifikimit?

Për të krijuar një kod vendndodhjeje përdorni kombinimin e shkronjave dhe të numrave për të identifikuar kuadratet / hapësirat në një sit, ose dhomat dhe katet në një ndërtesë. Për shembull, kodi i vendndodhjes së një objekti të evakuar nga salla 17 në katin përdhe të ndërtesës 1 të Muzeut Kombëtar mund të regjistrohet si më poshtë:

MK1-P-17-2

MK - Muzeu Kombëtar

1 - Numri i ndërtesës

P - Kati përdhe

17 - Dhoma 17

2 - Numri i vitrinës

Në mënyrë të ngjashme, kodi i vendndodhjes së një objekti të shpëtuar nga seksioni A1 i rrjetit kuadratik numër 1 në një sit të quajtur Park Kombëtar mund të regjistrohet si më poshtë:

PK-1-A1

PK - Parku Kombëtar

1- Numri i rrjetit kuadratik

A1 - Seksioni i rrjetit kuadratik

Në përgjithësi, sisteme të tilla numërimi shërbejnë për identifikimin e sitit ku ndodhet objekti, deri te përcaktimi i vendndodhjes së tij specifike. Kur është e përshtatshme, caktoni numra dhe shkronja për të identifikuar sitin, hapësirat / ndërtesat, katin, dhomat dhe vitrinat. Është e rëndësishme që të siguroheni që sistemi i numërimit të jetë i qëndrueshëm gjatë gjithë kohës, si dhe i kuptueshëm nga i gjithë personeli i përfshirë në një operacion evakuimi ose shpëtimi.

Si të krijoni një numër unik identifikimi dhe ta lidhni atë me kodin e vendndodhjes?



Para se të lëvizni një objekt, jepini një numër unik identifikimi, në mënyrë që të mund të gjurmoni lëvizjen e tij gjatë një operacioni shpëtimi ose evakuimi. Numri unik i identifikimit, së bashku me kodin e vendndodhjes, ndihmon për të identifikuar objektin dhe vendndodhjen e tij origjinale gjatë një operacioni shpëtimi ose evakuimi.



Numri unik i identifikimit është i ndryshëm nga kodi i vendndodhjes, pasi identifikon secilin objekt brenda një vendndodhjeje të caktuar. Sigurohuni që sistemi i numërimit, i zhvilluar për qëllime evakuimi ose shpëtimi, të jetë i thjeshtë, i unifikuar dhe i kuptueshëm nga të gjithë. Mund të jetë thjesht një sistem numrash rendor (p.sh., 01, 02) ose një kombinim i shkronjave dhe numrave (p.sh., A01, A02).



Nëse objekti është shpëtuar duke përdorur një rrjet kuadratik, numri unik i objektit me kodin e vendndodhjes mund të regjistrohet si në vijim:



Nëse keni kohë të kufizuar në sit dhe dokumentacioni i mëparshëm për identifikimin e dhomave dhe rafteve nuk është i disponueshëm, thjeshtojeni kodin e vendndodhjes, duke e ndarë ndërtesën në pjesë të gjera, p.sh., A, B, C. Regjistroni seksionet në një skicë të planit të ndërtesës. Nëse një ndërtesë ka shumë kate, shtoni numrat e kateve në secilën shkronjë, p.sh., A0 për katin përdhes dhe A1 për katin e parë etj.

Dokumentimi i evakuimit

Përdorni formatin e ilustruar më poshtë për të përgatitur një inventar gjatë evakuimit të objekteve. Kjo do t'ju ndihmojë të numëroni dhe të gjurmoni objektet derisa të zhvendosen në një hapësirë të sigurt për magazinimin e përkohshëm.

Numri rendor	Numri i mëparshëm	Numri i caktuar i identifikimit	Lloji i objektit	Materiali	Dimensionet: gjatësi, gjerësi, lartësi

Në rend progresiv numerik, nga 1 deri në objektin e fundit të lëvizur, tregon numrin e objekteve të evakuuara

Kjo fushë shërben për të shënuar numrin unik të identifikimit që i është dhënë çdo objekti gjatë evakuimit.

Lloji i objektit: përdoret për të përshkruar shkurtimisht objektin, p.sh., dorëshkrim i ilustruar, skulpturë, vazo etj.

Përbërja e objektit p.sh., qelq, qeramikë, metal, tekstil etj.



Pesha	Kodi i vendndodhjes origjinale	Numri i referencës të fotografisë ose të planimetrisë së katit	Vendndodhja e re	Numri i referencës së fotografisë ose të planimetrisë së katit

Listoni kodet origjinale te vendodhjes së objektit.

Kjo fushë duhet të mbushet pas evakuimit dhe vendosjes së objekteve në vendin e ri të sigurt.

Të gjitha fotografitë dhe planimetritë e kateve duhet të kenë një numër reference.

Shënoni peshën e objektit. Nëse nuk keni një peshore, përdorni simbole, si + për të treguar peshën. P.sh., nëse një objekt mund të mbahet lehtësisht nga një person përdorni + ; po kështu nëse duhen dy persona për ta mbajtur përdorni ++; dhe +++nëse nevojiten pajisje të veçanta për të ngritur dhe për të transportuar objektin.

Dokumentacioni i shpëtimit

Më poshtë është ilustruar një formular, i cili ndihmon për të regjistruar vendndodhjen origjinale të objekteve të shpëtua, numrat unikë të identifikimit, gjendjen, trajtimin e kryer për stabilizimin dhe kodin përfundimtar të zhvendosjes së tyre.

1 OBJEKTE TË GJETURA			
Nr. rendor	Vendndodhja origjinale	Numri i caktuar i identifikimit	Nr e mëparshëm

Në rend progresiv numerik, nga objekti i parë i lëvizur tek i fundit , tregohet numri i objekteve të shpëtua.

Kjo fushë tregon numrin unik të identifikimit që i është caktuar objektit.

2a KLASIFIKIMI SIPAS PËRPARËSISË DHE STABILIZIMI				
Pronari / Institucioni	Kodi origjinal i vendndodhjes	Lloji i objektit	Materialet	Përmasat: gjatësi, gjerësi dhe lartësi

Kjo fushë tregon kodin origjinal të vendndodhjes të objektit të shpëtuar. Kodi i vendndodhjes fillestar mund t'i referohet një numri rrjeti ose një kombinimi të numrave të rafit, ambientit dhe katit, në varësi të sistemit të miratuar për caktimin e kodeve të vendndodhjes.

Fusha 'Lloji i objektit' përdoret për të përshkruar shkurtimisht objektin.

Materialet përbërës i objektit p.sh., qelq, qeramikë, metal, tekstil etj.

2b KLASIFIKIMI SIPAS PËRPARËSISË DHE STABILIZIMI

Pesha	Nr. i referencës se fotove apo vizatimit	Lloji i dëmtimit	Trajtimi i kryer (të plotësohet gjatë stabilizimit)	Trajtimi i stabilizimit u krye nga
		“Numër referimi i fotografisë ose i vizatimit” i referohet fotografisë / vizatimit të objektit. Nëse nuk ka kohë të mjaftueshme për të bërë fotografi të objekteve individuale në vend, bëni fotografi të një grupi objekteve me numrat e tyre të identifikimit. Regjistroni numrin e fotos. Kjo fushë mund të plotësohet në fazën e klasifikimit sipas përparësisë ose në vendin e magazinimit të përkohshëm, në varësi të kohës në dispozicion.	Lloji i dëmtit tregon shkurtimisht gjendjen fizike të objektit, si edhe llojin e shkallës së dëmtimit që ka pësuar.	
Plotësoni peshën e objektit. Nëse nuk është e disponueshme një peshore, përdorni simbole, p.sh., përdorni + për të treguar që një person mund të lëvizë objektin, ++ për të treguar se duhen dy persona të lëvizin objektin, dhe +++ për të treguar se duhet më shumë se një person dhe pajisje të specializuara për të lëvizur objektin.			Kjo fushë përshkruan llojin e trajtimit të stabilizimit që i është bërë objektit. Për shembull, një objekt i lagur dhe i ndotur mund të duhet të shpëlahet përpara se të transferohet në magazinën e re të përkohshme. Trajtime të tilla duhet të jepen nga konservuesit dhe operatorët e trajnuar të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore.	

3 PAKETIMI DHE ZHVENDOSJA

Zhvendosur nga	Data	Kodi i zhvendosjes
		Kjo fushë tregon kodin e zhvendosjes për një objekt të caktuar pasi lëvizet për në hapësirën e re të magazinimit. Kjo fushë duhet të plotësohet pasi të gjitha objektet të jenë zhvendosur.

Udhëzues për trajtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore

- 1 Përdorni doreza me përbërje nitrili ose vinili për të trajtuar objekte të kontaminuara ose me pluhura. Sigurohuni që dorezat të jenë në madhësinë e duhur dhe të përshtaten me duart tuaja; përndryshe ju pa dashje mund ta rrëzoni ose ta dëmtoni objektin.
- 2 Ndërrojin dorezat kur bëhen shumë pis, për të shmangur ndotjen.
- 3 Vendosni maskë për mbrojtjen nga pluhurat nëse trajtoni objekte me pluhur ose të ndotura.
- 4 Hiqini stolitë dhe aksesorët tuaj që mund të krijojnë pengesa ose të gërvishin objektin.
- 5 Përpara se t'i zhvendosni objektet nga njëri vend në tjetrin, identifikoni një rrugë të lirë dhe sigurohuni që të mos ketë pengesa.
- 6 Përdorni gjithmonë të dyja duart për të mbajtur një objekt. Për të siguruar që pesha e objektit është e ekuilibruar, vendosni një dorë poshtë objektit dhe përdorni dorën tjetër për të mbështetur trupin e objektit.
- 7 Mos i mbani objektet nga dorezat, gryka ose pjesë të tjera delikate ose të dala.
- 8 Për të shmangur aksidente ose thyerje, mos mbani shumë objekte në të njëjtën kohë.
- 9 Kur është e mundur, përdorni govata (enë plastike në formë drejtkëndore, që mbajnë ujë ose objekte), kuti ose tabaka për të lëvizur objekte. Për transportimin në largësi të objekteve përdorni një karrocë nëse është e disponueshme.
- 10 Për objekte të rënda ose të mëdha duhen së paku dy persona për të transportuar objektin në mënyrë të sigurt.



Tandon, A. 2016. *Endangered Heritage: Emergency Evacuation of Heritage Collections*. Paris, UNESCO & Rome, ICCROM.
E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/7J4C-TJDK>

Heritage Collections Council. 1998f. *reCollections, Caring for Collections Across Australia — Handling, Transportation, Storage and Display*. Canberra, Heritage Collections Council.
E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/5XRJ-U9R3>

Udhëzues për paketimin e objekteve të trashëgimisë kulturore

- 1 Paketimi i papërshtatshëm mund të shkaktojë dëmtime fizike të përhershme te objektet e trashëgimisë kulturore, pasi ato zakonisht janë delikate për shkak të vjetërsisë së tyre ose të përdorimit në të kaluarën. Për këtë arsye, është e rëndësishme që, kur pakëtoni objekte të tilla gjatë evakuimit emergjent, të merrni parasysh sa vijon:



Objekte të paketuara për zhvendosje në një depo të përkohshme në Muzeun Kombëtar të Nepalit, Kathmandu, 2016. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

- Materialet e paketimit të përdorura duhet ta mbrojnë sipërfaqen e objektit dhe të zvogëlojnë ekspozimin ndaj goditjeve, dridhjeve, pluhurit, ndotësve të tjerë dhe ndaj luhatjeve të papritura në mjedisin e jashtëm.
 - Për të shmangur dëmtimin ose deformimin, materialet e përdorura për paketim duhet të përputhen me formën dhe madhësinë e objektit.
 - Duhet të jetë e lehtë të identifikosh objektin brenda paketimit të tij. Kjo do të ndihmojë në minimizimin e prekjës së tij.
- 2 Për të zgjedhur materialet e duhura të ambalazhimit është e rëndësishme të identifikohet përbërja e materialit të objekteve që do të pakëtohen. Për shembull, kur pakëtoni objekte me material bazë letre ose tekstile, sigurohuni që ato të mos vendosen në një enë që mund të lëshojë avuj acidë (p.sh., çdo gjë e bërë nga druri i pastazhionuar ose kompensata).
 - 3 Nga materialet në dispozicion, zgjidhni ato me cilësinë më të mirë për t'i vendosur në kontakt të drejtpërdrejtë me objektin. Në përgjithësi, pambuku natyral ose copa e napës e pangjyrosur mund të përdoret në mënyrë të sigurt për mbështjelljen e materialeve organike dhe joorganike.
 - 4 Ndërsa grumbulloni materiale për paketim, përpiquni të zgjidhni

materiale që mund t'i përdorni për qëllime të ndryshme. Kjo do të ndihmojë në uljen e kostove dhe siguron përdorimin efektiv të burimeve.

- 5 Për të pakëtuar objekte, zgjidhni kutitë që kanë kapak dhe janë të forta mjaftueshëm sa të vendosen njëra mbi tjetrën.
- 6 Nëse jeni duke përdorur kuti ose enë të ripërdorura, sigurohuni që të mos ketë mbetur asnjë ndotës brenda tyre, siç janë mbetjet e bimësisë, të insekteve ose të kimikateve.



Një kuti prej druri e veshur me copë pambuku jo të tendosur dhe jo të ngjyrosur, me qëllim që të sigurojë ambient të sigurt paketimi për tekstilet e mbështjella me napë, Nepal, 2016.

Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

- 7 Paketoni së bashku objekte të përbëra nga materiale të ngjashme. Përdorni ndarëse ose materiale amortizuese për të parandaluar kontaktin midis objekteve.
- 8 Mos vendosni sende të lehta dhe të rënda në të njëjtën kuti mbajtëse / arkë, pasi objektet e rënda mund të peshojnë mbi ato më të lehta dhe të shkaktajnë trysni ose thyerje.
- 9 Pasi të keni vendosur objektet në një arkë ose në një kuti, mbushni boshllëqet me materiale amortizuese për të parandaluar zhvendosjen e objekteve dhe goditjet e mundshme.
- 10 Për të pakëtuar dokumente me vlera ose vepra arti në letër ose papirus, përdorni kuti të sheshta. Përndryshe, mbështillni objektin në letër me cilësi të mirë, siç është letra e bërë nga napa pambuku dhe më pas vendoseni midis dy mbështetësve të ngurtë.




Uniformat dhe rrobat e tjera të shtrira dhe të vendosura në mbështetëse të ngurtë, Nepal, 2016.

Foto: Aparna Tandon, ICCROM

- 11 Për të pakeluar më shumë se një artikull prej letre, përdorni ndërmjet tyre fletë letre të bardha me cilësi të mirë, për t'i ndarë nga njëri-tjetri. Kjo do të ndihmojë për të zvogëluar riskun e transferimit të bojës ose të ngjyrës nga njëri objekt në tjetrin.
- 12 Për të ruajtur formën dhe strukturën e një libri, mbështilleni atë me letër me cilësi të mirë dhe më pas vendoseni vertikalisht me “kurrizin” (lidhje e kopertinës) përmbys në pjesën e poshtme të një govate / kutie.
- 13 Për të pakeluar një punim artistik (mbi letër ose tekstil) të madh në përmasa dhe të pakornizuar, përdorni një tub për magazinimin e punimeve dhe mblidheni atë rul në tub. Në fund, mbulojeni tubin me napë ose letër artizanale të një cilësie të mirë. Nëse një tub cilësor për materiale arkivore nuk është i disponueshëm, përdorni një tub kartoni me faqe të trasha dhe mbështillni rreth tij napën ose letrën me cilësi të mirë përpara se ta mbështillni veprën e artit mbi të. Sigurohuni që diametri i tubit të jetë i madh, pasi kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e riskut të dëmtimit prej rrudhosjes.
- 14 Paketoni në qese plastike të ndara objektet e brishta të përbëra nga materiale të tilla si balta, qelqi ose qeramika, para se t'i vendosni në një kuti të madhe. Përdorni amortizues dhe / ose materiale ndarëse për të shmangur kontaktin mes objekteve dhe për të shmangur dëmtimet nga fërkimi.
- 15 Për të siguruar paketimin e duhur në kushte emergjence, punoni në mënyrë të ngjashme me një linjë prodhimi / montimi.

Caktoni një person për mbështjelljen, një tjetër për përgatitjen e kutive dhe një person tjetër për etiketimin e objekteve me numrin unik të identifikimit dhe vendosjen e tyre në kutitë e përgatitura.

- 16 Sigurohuni që të gjitha kutitë të kenë etiketa që tregojnë numrin dhe llojet e objekteve që ato përmbajnë.
- 17 Në mënyrë që të shmangni lëvizjen dhe transportin e gabuar të kutive me objektet e trashëgimisë, shënojeni ato me shenjat e përdorura zakonisht: 'mbajeni të thatë', 'e brishtë', 'mbajeni këtë anë lart', 'poshtë', 'lart', qelq, dhe 'trajtojeni me kujdes'.



E marrë nga: Tandon, A. 2016. *Endangered Heritage: Emergency Evacuation of Heritage Collections*. Paris and Rome, UNESCO and ICCROM.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/7J4C-TJDK>

Materiale organike dhe joorganike



Materialet klasifikohen në organike ose joorganike. Përbërjet organike krijohen nga proceset e gjallesave, të bimëve apo të kafshëve. Përbërjet joorganike janë materiale që përgjithësisht nuk janë krijuar nga procese / cikle jetësore. Ato gjithashtu ndahen në materiale që vijnë nga burimet shtazore dhe bimore (ato organike) dhe nga burimet minerale (ato joorganike). Përfundimisht bëjnë guaskat dhe smaltet e dhëmbëve.

Materialet organike përfshijnë:

gëzofët, lëkurat, flokët, mëndafshet, brirët e *fildishtë*, zhguajt e breshkave dhe kockat, të cilat kanë prejardhje shtazore; si dhe drurin, fibrat e drurit (liri, fijet e kërpit dhe pambukut), letrën dhe gomën, të cilat kanë prejardhje bimore. Plastika zakonisht konsiderohet material organik.

Plastika prodhohet si nga materiale me origjinë bimore, ashtu dhe shtazore.

Materialet organike kanë karakteristikat e mëposhtme:

- përbërja e tyre kimike bazohet në zinxhirin karbonik;
- nëse nxehen, ato digjen në temperaturën e ambientit;
- janë subjekt sulmi nga mikroorganizmat dhe insektet;
- ato shkëmbejnë (përthithin dhe çlirojnë) avujt e ujit me atmosferën;

Materialet joorganike përfshijnë:

metalet, gurin, qelqin, qeramikën, guaskat (guaska është një material joorganik, edhe pse krijohet përmes procesit të jetës).

Materialet joorganike kanë karakteristikat e mëposhtme:

- nuk formohen nga zinxhiri karbonik;
- nuk digjen në temperatura normale të mjedisit;
- zakonisht nuk janë të ndjeshme ndaj dritës;
- nuk janë subjekt i sulmit nga insektet;
- nuk janë ushqim për mikroorganizmat.

Në përgjithësi, materialet organike janë më të ngrohta në prekje, më elastike dhe kanë dendësi më të vogël sesa materialet joorganike; ndërsa materialet joorganike priren të jenë më të forta dhe më të thyeshme. Secili prej nesh ka pasur shumë vite përvojë në njohjen e një game të gjerë materialesh, nga përdorimi i tyre në jetën tonë të përditshme. Duke e vëzhguar dhe prekur një objekt, ne zakonisht mund ta njohim materialin bazë nga i cili përbëhet objekti. Çdo material ka një kombinim të karakteristikave të dallueshme, si ngjyra, shkëlqimi, ngurtësia (ose përkulshmëria), struktura, aroma e pesha, të cilat ne i njohim.

Marrë nga: McCord, M., & Stone, T. 2002. Deterioration of Collections. *Generation 2: Education and Support Materials*. ICCROM unpublished material. Rome.



Canadian Conservation Institute. 2017. *Care of Objects and Collections*. Ottawa, Minister of Public Works and Government. E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/ZDG8-Y4UU>

Si të klasifikosh sipas përparësisë objektet e trashëgimisë kulturore kur rëndësia e tyre është e panjohur dhe kur dokumentacioni i mëparshëm nuk është i disponueshëm?



Kur vlerat e një objekti të trashëgimisë kulturore nuk mund të identifikohen përmes dokumentacionit ekzistues, është e rëndësishme të vendosen kritere, në mënyrë që të përcaktohet përparësia e evakuimit, e stabilizimit, e ruajtjes, e sigurisë dhe e trajtimit të ardhshëm të materialeve të trashëgimisë kulturore.

Kini parasysh sa vijon:

- **Cila është rëndësia e trashëgimisë kulturore për komunitetin vendas?** Në konsultim me administratorët dhe kujdestarët e trashëgimisë kulturore që është prekur, përpuni të përcaktoni përgjigjet për kriteret e vlerësimit. Për shembull: cila është vjetërsia e objektit? Cila është rëndësia e objektit në kujtesën kolektive ose identitetin e komunitetit?
- **Cili është lloji dhe shkalla e dëmtimit të trashëgimisë kulturore?** Për shembull, kushtojini përparësi objekteve të thata dhe të paprekura krahasuar me ato që janë lagur dhe thyer. Paketoni dhe zhvendosni më parë objektet e padëmtuara.
- **Nga se janë të përbëra objektet?** Objektet që janë të përbëra nga materiale organike (letër, tekstile, dru, produkte shtazore - si kockat) duhet të kenë përparësi mbi objektet që janë të përbëra nga materiale joorganike. Materialet joorganike, si guri, qeramika dhe metali, ka më pak të ngjarë të pësojnë dëme të mëtejshme nëse trajtimi vonohet.
- **Cilat janë risqet?** Cilat janë risqet për një objekt nëse lihet në gjendjen aktuale të dëmtimit? A do të rritet dëmi nëse nuk trajtohet?
- **Cila është madhësia dhe pesha e objektit?** Ju mund të mos keni kohë ose mjete të mjaftueshme për të lëvizur objekte me përmasa të mëdha ose ato që janë shumë të rënda, p.sh., mozaikë të shkullur ose piktura në kornizë me dimensione të mëdha. Largoni objektet më të lehta që janë të lëvizshme (luajtshme) dhe siguronit objektet e rënda ose të mëdha në sit.



Van Balen, K. 2008. The Nara Grid: An Evaluation Scheme Based on the Nara Document on Authenticity. *APT Bulletin*, 39(2/3): 39-45.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/DL8A-E32V>

Russell, R. & Winkworth, K. 2009. *Significance 2.0: A guide to assessing the significance of collections*. Canberra, Collections Council of Australia Ltd.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/GJ8G-ERAN>

Australia International Council on Monuments and Sites (ICOMOS). 2013. *TheBurraCharter: TheAustraliaICOMOSCharterforPlaces of Cultural Significance*, 2013. Burwood, ICOMOS.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/ULL9-UY9U>

Stabilizimi i trashëgimisë kulturore që është e luajtshme dhe e dëmtuar



Pastrimi në të thatë i sipërfaqeve

Kur është i përshtatshëm pastrimi në të thatë i sipërfaqeve?

- Pastrimi në të thatë i sipërfaqes është i përshtatshëm kur ka mjaft papastërti ose pluhur që dëmton vetë objektin, ose objektet në afërsi të tij.
- Objekti duhet të jetë i fortë strukturalisht ose i mbështetur mirë. Mos pastroni objekte ose elemente strukturore të copëtuara që janë të brishta. Nëse shqetësoheni se mos një objekt mund të thyhet gjatë pastrimit, mos u përpiqni ta pastroni.
- Merrni parasysh brishtësinë e elementeve dekorative, si ato që janë të ngjyrosura me pigmente ose shtresa ari. Rimendojeni nëse është patjetër e nevojshme ta kryeni pastrimin nëse ka gjasa që materiali origjinal të hiqet apo shkëputet gjatë pastrimit.
- Bëni kujdes kur pastroni material arkeologjik. Objektet arkeologjike mund të kenë në sipërfaqe ose brenda tyre depozitime në formë koreje ose papastërti me rëndësi shkencore. Për të parandaluar pastrimin e tepërt, kërkoni ndihmë nga një restaurator ose një arkeolog për t'u siguruar që të mos hiqni të dhëna të rëndësishme shkencore. Nëse nuk ka një ekspertizë të tillë të disponueshme, pastroni me furçë vetëm papastërtitë e lehta nga pjesa e jashtme e objektit. Asnjëherë mos e pastroni nga brenda atë.



Pastrimi në të thatë me një furçë të butë me fije i sipërfaqes së një kutie të pikturuar, Haiti, 2010. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

Si të pastroni sipërfaqet e thata?

- 1 Për papastërtitë e lehta mbi sipërfaqe, ose për pluhurin e rëndë, mund të përdoren furça me fije të buta ose pastrues me vakum për të thithur ndotësit. Ndotësit, si pluhuri, bloza, pislleqet dhe papastërtitë e tjera mund të hiqen duke përdorur **furça me fije të buta** dhe **sfungjerë**. Nëse keni mundësi të përdorni mjet me energji elektrike të pandërprerë dhe një fshesë me korrent (rryme) me një filtër **“High-Efficiency Particulate Absorbing - HEPA” (Thithës grimcash me efektivitet të lartë)**, ajo mund të përdoret për të hequr mykun sipërfaqësor dhe substancat ndotëse të ngurtësuar.
- 2 Nëse përdorni një fshesë me korrent, mbulojani grykën me rrjetë të hollë ose me napë, në mënyrë që të keni kontroll më të madh mbi presionin e ajrit dhe të mos thithni aksidentalisht një pjesë të objektit. Nëse përdorni fshesën e korrentit për të hequr papastërtitë nga një objekt dy-dimensional, mbajeni me kujdes grykën e fshesës mbi pjesën e sipërme të objektit (pa e prekur) dhe pastrojeni me furçë të butë duke i çuar papastërtitë drejt grykës.
- 3 Për blazën ose grimca të tjera shumë të imëta përdorni një **sfungjer të thatë** me bazë gome për të hequr ndotësit. Mos përdorni kurrë sfungjer në objekte metalike. Në vend të tij përdorni **furçë ose napë**.
- 4 Për pastrimin e sipërfaqes së një objekti tre-dimensional mbajeni atë në mënyrë të sigurt para se të përpiqeni të përdorni një furçë ose sfungjer. Nëse objekti është i madh, i rëndë ose i pavolitshëm për t’u mbajtur, kërkon dikë që ta mbajë të palëvizur objektin.
- 5 Për të pastruar sipërfaqen e një objekti dy-dimensional, siç është një vepër arti në letër ose një pikturë në kanavacë, vendoseni objektin në një sipërfaqe të pastër dhe të sheshtë, e cila është mbuluar me **mushama** ose **plastikë**. Kërkon një person tjetër që ta mbajë objektin në qoshet e sipërme dhe të poshtme njëkohësisht dhe më tej pastroni me furçë të butë pluhurin ose ndotësit.
- 6 Kur pastroni ndotësit me furçë, bëni kujdes dhe sigurohuni që nuk po e gërvishni sipërfaqen e objektit. Për të parandaluar gërryerjen, mos ushtroni shumë presion kur përdorni furçën, dhe përdoreni vetëm në një drejtim.
- 7 Kur përdorni një sfungjer për të hequr ndotësit e imët sipërfaqësorë, siç është bloza, mos e fërkoni sfungjerin mbi objekt. Shtypeni lehtë sfungjerin në zonën e bërë pis për të thithur ndotësin. Kur sipërfaqja e sfungjerit të jetë bërë shumë pis, priteni pjesën e pisët të sfungjerit me gërrshërë dhe vazhdoni pastrimin me pjesën e pastër të sfungjerit.



Australian War Memorial. n.d. *Conservation advice: Cleaning Soot Damaged Objects*. Canberra, The Australian War Memorial. E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/Q38H-G6KT>

Canadian Conservation Institute. 2017. *Care of Objects and Collections*. Ottawa, Minister of Public Works and Government. E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/ZDG8-Y4UU>

Heritage Collections Council. 1998d. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Managing Collections*. Canberra, Heritage Collections Council. E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/5NAY-J562>

Scott, M. 2003. *Bushfires...Protect Your Precious Possessions*. Melbourne, University of Melbourne. E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/8KVN-5YJQ>



Pastrimi i sipërfaqeve të lagura

Kur është i përshtatshëm pastrimi i sipërfaqeve të lagura dhe çfarë mjetesh nevojiten?

- 1 Pastrimi duhet të bëhet vetëm për objekte që janë tashmë të lagura dhe me ndotje të konsiderueshme, si p.sh., nga balta.
- 2 Pastrimi duhet të kryhet nën mbikëqyrjen e restauratorëve profesionistë ose operatorëve me përvojë të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore.
- 3 Sigurohuni që të keni përgatitur materiale dytësore ndihmëse për tharjen e materialeve të lagura.
- 4 Duhet të keni mundësi furnizimi me ujë të pastër dhe të rrjedhshëm.
- 5 Sigurohuni që të keni një hapësirë të madhe në dispozicion për përdorimin dhe largimin e ujit të ndotur. Mbajeni këtë zonë të ndarë nga vendet e thata të punës për të shmangur ndotjen e objekteve të tjera.

Si të pastroni materialet e lagura?

- Vendosni në rresht në një vend të sheshtë disa **govata** të cekëta dhe mbushini me ujë të pastër. Numri i govatave që do t'ju nevojiten do të varet nga sa janë të ndotura objektet dhe nga sasia e objekteve që kërkojnë pastrim. Duhet të keni të paktën tri govata në dispozicion për shpëlarjen e objekteve.

- Vendoseni objektin e lagur në një mbështetëse të papërshkueshme nga uji, siç mund të jetë një **fletë plastike e ngurtë** ose **rrjetë poliesteri** (për objekte, si letra, fotografi dhe tekstile të vogla të rrafshta). Sigurohuni që mbështetësja që po përdorni për të objektin të jetë më e madhe se vetë objekti.
- Vendosni me kujdes objektin brenda govatës së parë. Trazoni ujin me duar dhe hiqni butësisht baltën dhe papastërtitë e tjera. Mos përdorni furça ose mjete të tjera për të hequr papastërtitë.
- Hiqeni objektin nga govata e parë dhe çojeni në govatën e dytë me ujë të pastër. Përsëriteni procesin e shpëlarjes dhe lëvizni në govatën e tretë. Vazhdojeni procesin derisa të keni arritur në govatën e fundit dhe mbetjet e baltës të jenë hequr plotësisht.

Për materialin fotografik

Diapozitivët dhe negativët e fotografive mund të shpëlahen dhe të lihen që të thahen në ajër, duke përdorur metodologjinë e sipërpërmendur. Megjithatë, fotografitë duhet të shpëlahen nën mbikëqyrje, sepse disa lloje fotografish mund të kenë nevojë për trajtim të specializuar.



Fotografitë e lagura me depozitime sipërfaqësore me baltë, të mbështetura në fletë poliesteri për shpëlarje në govata, Itali, 2017. Foto: ICCROM.

Për librat

Një libër i lagur dhe i mbyllur, që është i ndotur me baltë nga jashtë, duhet të mbahet i mbyllur gjatë shpëlarjes. Përdorni forcën shtypëse të duarve për të hequr ujin e tepërt. Mos e hapni librin dhe mos përdorni forcë të tepruar kur shtypni me duar.

Për tekstilet

Mos i shtrydhni dhe mos i përdridhni tekstilet për të hequr ujin e tepërt. Përdorni një sfungjer të trashë për të thithur ujin. Vendoseni sfungjerin mbi tekstilin e lagur dhe ngjesheni butësisht për të thithur ujin. Kur sfungjeri të jetë i mbushur, hiqeni dhe shtrydhjeni ujin e ndotur në një kovë. Shpëlajeni sfungjerin para se ta përdorni sërish.



Për objekte me përmasa të mëdha (nevojiten dy persona)

Nëse objekti është shumë i madh ose i rëndë për t'u vendosur në një govatë, kur është e mundur, vendoseni pranë një rubineti me ujë të rrjedhshëm. Një person mund të mbajë objektin, ndërsa personi tjetër e shpëlan me një currilë të lehtë uji. Nëse nuk ju gjendet një zorrë ose tub uji, zhytini sfungjerët në ujë të pastër dhe shtrydhini ato mbi objekt, ose përdorni enë të vogla për të derdhur butësisht ujë mbi sipërfaqe. Pasi të pastrohet, thajeni lehtë me sfungjer ose me një leckë që e thithë ujin.



Department of Homeland Security Federal Emergency Management Agency. 2018. *Reclaiming Precious Heirlooms From Flood Waters*. Washington, DC, U.S. Department of Homeland Security.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/XY64-GPM6>

Levitani, A. 1993. Emergency Treatment for Water-Soaked Furniture and Wooden Objects. *National Parks Service Conserve O Gram*, 7(7). Washington, DC, U.S. Department of the Interior.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/4J9T-SFVZ>

State Library of Queensland. 2014a. *Caring for your collections: Salvaging water damaged collections*. Brisbane, Queensland Government.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/8V9X-YFNS>

Metodat për tharjen e objekteve

Tharja në ajër e objekteve të lagura

Objektet e trashëgimisë kulturore shpesh përbëhen nga përzierje materiale, dhe kur është e mundur duhet të thahen në kushte të kontrolluara. Një nga metodat më të thjeshta për tharjen e objekteve është tharja e tyre në ajër

Kushtet për tharjen me ajër të objekteve:

- Gjeneri një zonë të freskët dhe të thatë (jo të lagësht). Nëse është e mundur, merrni disa ventilatorë të fuqishëm dhe aparate për uljen e lagështisë me ajër të kondicionuar, në mënyrë që të siguronin një qarkullim të mirë të ajrit dhe një lagështi relativisht të ulët në dhomën ku po punoni. Nëse nuk jeni në gjendje të merrni ventilatorë të mëdhenj, të paktën sigurohuni që dhoma të jetë e ajrosur mirë, ose përdorni ventilatorë të vegjël të lëvizshëm.
- Shmangeni ekspozimin direkt ndaj rrezeve të diellit e objekteve që duhen tharë. Shmangia e rrezeve direkte të diellit do të parandalojë zbardhjen e objekteve ose shformimin gjatë procesit të tharjes.
- Nëse është e mundur, për të kursyer hapësirë, përdorni rafte me grila për tharjen ose rafte të lëvizshme me rrota për të tharë shumë objekte të vogla njëkohësisht.

Si t'i thajmë objektet me ajër?

Për metalet

Metalet ndryshken nëse lihen në lagështi për një kohë të gjatë. Thani objektet prej metali sa më shpejt të jetë e mundur. Përdorni peshqirë të butë dhe çarçafë pambuku për të thithur lagështinë dhe për të mbështetur objektet kur ato thahen. Nëse është e nevojshme, përdorni një ventilator të lëvizshëm për të shpejtuar procesin e tharjes.



Tharja me ajër e objekteve metalike gjatë një simulimi emergjence, Dublin, 2017.

Foto: ICCROM dhe Komiteti Kombëtar Irlandez për Mburoja Blu

Për qeramikën dhe qelqin

Përdorni peshqirë të butë dhe çarçafë pambuku për të thithur lagështinë dhe për të mbështetur qeramikën e brishtë dhe objektet prej qelqi, ndërkohë që ato thahen. Ndërronini peshqirët dhe çarçafët kur ato nuk janë në gjendje të thithin më lagështi.

Për objektet prej kocke dhe ato prej fildishi

Përdorni **sfungjerë** për të hequr lagështinë nga objektet e përbëra nga kocka dhe fildishi. Vendosni **rrjetë poliesteri** ose fletë të lehta prej **polietileni** mbi pjesën e sipërme të objekteve, për të ngadalësuar procesin e tharjes. Tharja shumë e shpejtë e kockave ose e fildishit mund të shkaktojë plasaritje dhe ta bëjë objektin më të thyeshëm.

Për tekstilin dhe lëkurën

Mbulojini tekstilet dhe sendet prej lëkure me materiale thithëse të pangjyroshura, si **letra thithëse** ose **peshqirë të bardhë dhe pëlhura pambuku**. Thajini ato në formën që i keni gjetur, duke i vënë horizontalisht në një vend të sheshtë. Mos u përpiqni të ndryshoni formën e objektit ndërsa është duke u tharë.

Për objektet me bazë bimore

Përdorni letër thithëse, si **letra ushqimore**, për të hequr lagështinë e tepërt nga objektet e përbëra nga fibrat e bimëve, si shportat e thurura. Vendosni **rrjetë poliesteri** mbi pjesën e sipërme të objekteve për të kontrolluar procesin e tharjes. Mos u përpiqni t'i ndani pjesët e objektit ose t'i riformoni ato gjatë procesit të tharjes.

Për librat

Nëse një libër është pak i lagur dhe ka lidhje anësore dhe kapak të fortë, vendoseni të qëndrojnë vertikalisht dhe pak i hapur mbi një sipërfaqe të pastër dhe të sheshtë dhe përdorni ventilatorë që të thahet.



Tharja me ajër e një libri të vendosur vertikalisht gjatë një simulimi emergjence, Dublin, 2017. Foto: ICCROM dhe Komiteti Kombëtar Irlandez për Mbujoja Blu.

Librat që janë plotësisht të lagur duhet të thahen horizontalisht. Hiqjani lagështinë e tepërt duke e mbështjellë librin me **letër thithëse** pa ngjyrosje. Për tharjen e librave të shtypur, vendosni letra thithëse ndërmjet faqeve të librit për t'i tharë ato në mënyrë më efektive. Sigurohuni që materiali i vendosur ndërmjet faqeve të jetë më i madh se libri për të thithur më mirë lagështinë dhe sigurohuni që të mos arrijë në brendësi deri në lidhjen anësore të librit. Kjo do të ndihmojë për të shmangur shtrembërimin e lidhjes së librit. Ndërrojeni materiali thithës kur mbingopet.

Nëse faqet e librit janë prej letrë me shkëlqim, përdorni **rrjetë poliesteri** si material ndërmjet faqeve.

Për librat me kapak të lyster, vendosni **letër frigoriferike** midis kapakut dhe faqeve të brendshme për të parandaluar transferimin e njollave të bojës.

Për piktura, vepra arti në letër dhe materiale fotografike

Kur është e mundur, ndajini kornizat e dëmtuara nga pikturat, veprat e artit dhe fotografitë. Nëse vepra e artit ose fotografia është e ngjitur në xhamin e kornizës, mos u përpiqni ta ndani atë nga xhami.

Nën mbikqyrjen e ekspertëve, hiqni me kujdes pikturat, veprat e artit dhe fotografitë nga kornizat ose nga mbajtëset e tyre. Hiqini këto objekte nga mbajtëset e tyre vetëm nën mbikqyrjen e ekspertëve.

Thajini fotografitë, pikturat dhe veprat e artit duke ia lënë fytyrën nga lart.

Përdorni rrjetë poliesteri ose letra thithëse për të mbështetur veprat e artit të realizuara në letër, kanavacë dhe tekstil. Në rastin e veprave artistike dhe fotografive ende të ngjitura në xham, thajeni duke ia lënë fytyrën nga lart në një pozicion horizontal. Shmangni ekspozimin e drejtpërdrejt ndaj rrezeve të diellit.



Heritage Collections Council. 1998d. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Managing Collections*. Canberra, Heritage Collections Council.
E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/5NAY-J562>

Ngrirja për tharjen e objekteve të lagura dhe ngrirja me vakum



Kur është e mundur, tharja nëpërmjet ngrirjes është mënyra më efektive për të stabilizuar sasi të mëdha të objekteve organike dhe materialeve bibliotekare dhe arkivore që janë dëmtuar nga uji. Tharja nëpërmjet ngrirjes heq akullin nga materiali dhe e kthen atë në avull. Tharja nëpërmjet ngrirjes me vakum është edhe më efektive dhe përshpejton procesin e tharjes, duke hequr ajrin dhe avujt e ujit nga materiali.



Tharja me ngrirje dhe ruajtja e materialeve organike në temperatura të ulëta pas një ngjarjeje të rrezikshme do të mundësojë më shumë kohë për të gjetur fonde për rimëkëmbjen e infrastrukturës së dëmtuar dhe, nga ana tjetër, do të ndihmojë në rehabilitimin e materialeve të rikupëruara në një mjedis të qëndrueshëm.



Objektet me materiale të përziera, si druri, fildishi, kocka dhe letra, mund të shformohen gjatë tharjes nëpërmjet ngrirjes. Shformimi shkaktohet nga vetitë e ndryshme të përthithjes që materialet kanë, duke çuar shpesh në tharje jo uniforme.

Përgatitja e objekteve për ngrirje

- Kur të keni organizuar një hapësirë për ruajtjen frigoriferike, vini re specifikimet e materialit që do përdoret për paketimin dhe ruajtjen në frigorifer. Do të duhej ta siguronit këtë informacion nga kompania që ofron shërbimin. Në përgjithësi janë të përshtatshme për ruajtjen e sendeve të lagura në ngrirje kutitë e forta të kartonit ose arkat plastike që përdoren për të mbajtur shishet / kutitë e qumështit, bukën ose frutat.
- Sigurohuni që të keni mundësi të përdorni kamionë frigoriferikë për të transportuar materialet e lagura në depo.
- Mos shpëlani dhe mos lani sasi të mëdha materialesh të brishta organike.
- Paketojini librat ngjitur me njëri-tjetrin, me “kurrizin” (pjesën lidhëse të kopertinës) nga poshtë, për të shmangur shformimin ndërsa thahen.
- Përdorni letër ose qese frigoriferike për të ndarë sende të veçanta, siç mund të jenë librat e veshur me lëkurë. Shënoni cilat objekte kanë përparësi dhe duhet të kontrollohen gjatë procesit të tharjes me ngrirje.



Dëmtimi dhe përqekësimi

Australian Institute for the Conservation of Cultural Material. 2017. *Visual Glossary*. Canberra, Australian Institute for the Conservation of Cultural Material.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/4P8N-5GBP>

Canadian Conservation Institute. 2017. *Agents of Deterioration*. Ottawa, Minister of Public Works and Government Canada.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/S65F-KNA5>

Kujdesi për koleksionet e trashëgimisë kulturore

Canadian Conservation Institute. 2017. *Care of Objects and Collections*. Ottawa, Minister of Public Works and Government.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/ZDG8-Y4UU>

Heritage Collections Council. 1998a. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Caring for Cultural Material 1*. Canberra, Heritage Collections Council.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/9DS2-DRPA>

Heritage Collections Council. 1998b. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Caring for Cultural Material 2*. Canberra, Heritage Collections Council.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/49CQ-QVUV>

Materialet dhe pajisjet për evakuim



Në varësi të llojit të emergjencës dhe sitit për të cilin po regjistroni të dhënat, pajisjet e mëposhtme duhet të sigurohen para mbërritjes në vendndodhje.



Për dokumentim

- ☐ Kamera me bateri rezervë për dokumentim fotografik
- ☐ Blllok shënimesh, letër milimetrike dhe bllloqe / fletore
- ☐ “Clipboard” (tabelë dore me kapëse për mbështetjen e letrave)
- ☐ Lapsa dhe stilolapsa shumëngjyrësh të papërshkueshëm nga uji (rapid)
- ☐ Metër shirit
- ☐ Një latë e hollë, 2 metra e lartë, për dokumentimin e objekteve të mëdha dhe për të kuptuar shkallën dhe kontekstin e objekteve në foto
- ☐ Mashtabë (vizore) me ndarje 10 cm, për dokumentimin e objekteve të vogla ose për fotografitë nga afër
- ☐ Karton i fortë dhe ngjitës shirit
- ☐ Spango pambuku dhe rripa najloni, për të lidhur etiketat dhe paketimet
- ☐ Etiketa ngjitëse, për t’u përdorur mbi kutitë dhe paketimet, si dhe për të shkruar numrat e identifikimit të objekteve. Etiketa të tilla nuk duhet të ngjiten në sipërfaqen e objektit.

Për paketim dhe transport

- ☐ Napë e bardhë natyrale ose petk pambuku i hollë. Këto mund të përdoren në mënyrë të sigurt si material mbrojtës ose për të mbështjellë shumë prej objekteve. Ky lloj materiali gjendet lehtësisht.
- ☐ Letër e pastër pambuku: një zëvendësues i mirë i letrës pa acid dhe lehtësisht i disponueshëm. Letra e përbërë nga pambuku dhe / ose prej liri mund të përdoret për të mbështjellë punimet në letra dhe punime tekstili.
- ☐ Film poliesteri: një fletë plastike e tejdukshme dhe pa ngjyrë që përdoret për të ruajtur fotografi ose dokumente të tjera prej letrë. Zakonisht shitet si ‘Mylar’ ose ‘Melinex’.

- ☐ ‘Tyvek®’: një material sintetik i përbërë nga fibra polietileni me densitet të lartë, i cili mund të përdoret si mbulesë rezistente e papërshkueshme nga uji. Zakonisht përdoret për të mbrojtur ndërtesat gjatë ndërtimit.
- ☐ Mushama
- ☐ Material ambalazhues - “shkumë” - prej polietileni: zakonisht shitet si ‘Ethafoam’ dhe mund të përdoret si një material amortizues, pasi mund të pritët lehtësisht për të krijuar një vend të përshtatshëm për një objekt që pakëtohet, duke minimizuar goditjet.
- ☐ Qese ambalazhi me flluska: shërbeni si një zgjidhje afatshkurtër dhe mund të përdoret si material amortizues ndaj goditjeve. Sidoqoftë, sipërfaqja me flluska nuk duhet të jetë në kontakt të drejtpërdrejtë me objektin.
- ☐ Jastëk / Shilte: shillet dhe jastëkët e zakonshëm mund të përdoren për të pakëtuat objekte të brishta.
- ☐ Peshqirët: peshqirët e bardhë prej pambuku mund të përdoren si material amortizues.
- ☐ Qese polietileni: qeset prej polietileni për përdorim ushqimor mund të përdoren për të pakëtuat objekte të brishta ose të vogla.
- ☐ Kuti kartoni: kutitë e zakonshme të kartonit mund të përdoren për të mbajtur objektet. Sidoqoftë, ndërsa vjetrohen, ato mund të lëshojnë avuj me acide që mund të jenë të dëmshëm për objektet. Në mënyrë që të mbrohen objektet, rekomandohet që pjesa e brendshme e kutisë së kartonit të jetë e veshur me pambuk të pangjyrosur ose letër të pastër prej pambuku.
- ☐ Arka frutash prej druri: zakonisht të bëra prej druri me cilësi të dobët, arka të tilla mund të përdoren për të transportuar materiale joorganike, si guri ose argjila. Sidoqoftë, ato duhet të jenë të veshura me letër ose me pambuk. Përdorimi i arkave të tilla është në thelb një zgjidhje afatshkurtër.
- ☐ Kuti plastike: enë të tejdukshme prej plastike që përdoren zakonisht për të ruajtur ushqimin mund të shërbejnë si enë mbajtëse për sende të brishta ose të vogla.
- ☐ Arka plastike: shpesh përdoren për të transportuar kartonë qumështi ose fruta / perime dhe janë një zgjidhje tjetër afatshkurtër për ruajtjen dhe për transportimin e objekteve.

- ☐ Govata plastike: zakonisht përdoren në muze dhe arkiva, govata plastike të cekëta të përbëra prej polietileni mund të përdoren në mënyrë të sigurt për të ruajtur dhe për të transportuar objekte.
- ☐ Tuba për mbledhjen e posterave: tuba me diametër të gjerë mund të përdoren për të paketuar kanavacë, letra dhe punime tekstili.
- ☐ Paleta: paleta plastike ose druri mund të përdoren për të mbajtur kutitë që përmbajnë objekte dhe për të mos i vendosur ato në tokë. Sidoqoftë, nëse përdorni paleta druri, sigurohuni që ato të jenë pa insekte dhe të jenë të mbuluara me fletë polietileni ose mushama, për të parandaluar kontaktin e drejtpërdrejtë me kutitë që përmbajnë objekte të trashëgimisë.
- ☐ Ngjitës shirit për paketime
- ☐ Gërshërë
- ☐ Brisk / thikë prerëse
- ☐ Fletë ngjitëse për etiketimin e kutive dhe magazinave

Materiale shtesë

- ☐ Litar
- ☐ Vizore
- ☐ Kova
- ☐ Shkallë portative
- ☐ Karroca transporti
- ☐ Karrocë dore



Materiale dhe pajisje për procesin e shpëtimit

Këto lista nuk janë shteruese. Këtu janë renditur materiale që janë lehtësisht të disponueshme. Mos hezitoni të përdorni materiale më të përshtatshme, nëse jeni në gjendje t'i gjeni në sasi të mjaftueshme ose të përdorni materiale që gjenden në vend, për sa kohë që jeni të sigurt që po i përdorni ato pa rrezikuar objektet ose strukturat që po stabilizoni.

Për sigurimin e një siti

- ☐ Shirit sinjalizues për të kufizuar zonat e pasigurta ose zonat me qasje të kufizuar.
- ☐ Rrjetë teli: rrethim metalik bazik i galvanizuar. Mund të përdoret për të ndaluar hyrjen në zona të veçanta.
- ☐ Sinjalistikë (tabela) sigurie me shenjat më të përdorura zakonisht për të treguar zonat e rrezikshme ose zonat e kufizuara të hyrjes. Sinjalistika duhet të jetë e madhe, e dukshme në mënyrë të qartë dhe e lehtë për t'u kuptuar nga i gjithë personeli.
- ☐ Shirit ngjithës i fortë: rezistent ndaj ujit dhe trysnisë.
- ☐ Shkopinj druri për të lidhur / mbajtur sinjalistikën e sigurisë dhe shiritin sinjalizues.
- ☐ Pllaka druri (petavra) për të siguruar dyshemetë e dobësuar gjatë procesit të vlerësimit.
- ☐ Një shkallë portative për të arritur objektet e varura që mund të trajtohen lehtësisht.

Për dokumentim

- ☐ Kamera me bateri rezervë për dokumentim fotografik
- ☐ Bllok skicash, letrë milimetrike dhe blloqe / fletore
- ☐ "Clipboard" (tabelë dore me kapëse për mbështetjen e letrave)
- ☐ Lapsa dhe stilolapsa shumëngjyrësh të papërshtueshëm nga uji (rapid)
- ☐ Metër shirit
- ☐ Mashtabë (vizore) me ndarje 10 cm, për dokumentimin e objekteve të vogla ose për fotografitë nga afër
- ☐ Karton i fortë dhe ngjitës shirit
- ☐ Spango pambuku dhe rripa najloni, për të lidhur etiketat dhe paketimet


- ☐ Etiketa ngjitëse, për t'u përdorur mbi kutitë dhe paketimet, si dhe për të shkruar numrat e identifikimit të objekteve. Etiketa të tilla nuk duhet të ngjiten në sipërfaqen e objektit.



Për stabilizimin e objekteve të dëmtuara

- ☐ Spango ose litar me ngjyrë për të bërë një rrjet kuadratik
- ☐ Mushama
- ☐ Etiketa dhe fletë ngjitëse për shënime
- ☐ Lapsa dhe shënues shumëngjyrësh të papërshkueshëm nga uji (rapid) për etiketim
- ☐ Furça të sheshta të buta në madhësi të ndryshme
- ☐ Furça dhëmbësh për pastrimin e vazove prej balte (poçeri) dhe qeramikës
- ☐ Sfungjerë të dimensioneve të ndryshme
- ☐ Sfungjerë të thatë me bazë gome fshirëse: këto gjenden nga furnizuesit e restauratorëve dhe në dyqanet e artit dhe artizanatit.
- ☐ Letra kuzhine
- ☐ Qese plastike me mekanizëm mbyllës
- ☐ Govatë e cekët
- ☐ Rrjetë ose thurje rrjetash poliestër
- ☐ Fshesë me korrent (rrymë), nëse është e mundur
- ☐ Kova
- ☐ Karroca me rafte
- ☐ Varëse që përdoren për tharje rrobash
- ☐ Kuti rezistente kartoni dhe plastike.





Mashtabë 10 cm
(vizore)



Brisk / thikë
prerëse



Shirit sinjalizues



Spango
pambuku



Napë e
bardhë natyrale



Metër shirit



Ngjitës shirit për
paketim



Sfungjer të
thatë prej gome
natyrale




Paleta



Film poliestër



Mbështjellëse/
qese me filluska



Ambalazh
(shkumë)
polietilen



Letër e pastër
pambuku



"Tyvek" rolon -
mbulesë rezistente
e papërsh-
kueshme nga uji



Rrip najloni



Shkallë portative



Karroce me rafte



Sinjalistikë
sigurie



Govatë e cekët



Tuba për mbledhjen e
posterave



Arka plastike



Latë

Si të ngrini një strehë të përkohshme për objektet dhe koleksionet e ekspozuara të trashëgimisë kulturore?



- 1 Matni gjatësinë dhe gjerësinë e grumbullit të mbetjeve.
- 2 Siguroni një mbulesë rezistente të papërshueshme nga uji, siç është mushamaja, me përmasa më të mëdha se grumbulli i mbetjeve që keni matur. Nëse nuk mund të gjeni material mjaftueshëm të madh për të mbuluar sipërfaqen, ngjisni së bashku aq material sa nevojitet me një ngjitës shirit të fortë dhe rezistent, për të formuar përmasën që ju duhet.
- 3 Mbulojini mbetjet dhe sigurojeni strukturën në tokë duke e gozhduar me kunja për fiksimin e tendave, ose duke vendosur pesha të rënda te qoshet. Në të kundërt, nëse fondet e mundësojnë, mund të ngrihet një tendë që e mbulon gjithë sipërfaqen.




Si të ndërtoni një strukturë të përkohshme për një mbulesë?


Më poshtë janë disa këshilla për ndërtimin e një strukture të përkohshme. Nëse struktura duhet të mbështesë një çati të rëndë, mos u përpiqni të ndërtoni një strukturë pa ekspertizën e një inxhinieri.

Përgatitja e një strukture


Një strukturë përbëhet nga shtylla vertikale, trarë horizontale dhe shtrëngues diagonalë për ta mbajtur strukturën të qëndrueshme. Strukturat drejtkëndëshe shformohen shpejt nën ngarkesat horizontale. Strukturat trekëndore janë shumë më rezistente. Përforcimi i një strukture drejtkëndëshe duke e lidhur me elemente diagonale do të parandalojë shformimin.



JO




PO



PO


Vizatimi: E. Crété

Ju mund të përdorni lëndë druri, bambu ose tel për të përforcuar strukturën në mënyrë diagonale. Nëse përdorni tel, duhet ta shpërndridhni atë rreth vetes me anë të një cope druri ose me një gozhdë të madhe, në mënyrë që të rritni rezistencën e tij. Për më tepër, kur përdorni tel, duhet t'i shtrëngoni të dyja diagonalet e murit (ndërsa kur përdorni bambu ose lëndë drusore, mjafton vendosja e një diagonaleje për ta përforcuar).



Vizatim i përshtatur nga: Federata Ndërkombëtare e Shoqërive të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC). n.d. "The IFRC Shelter Kit". Gjenevë, IFRC

Nëse përdorni një element të papërkulshëm, një tjetër element diagonal do të jetë i mjaftueshëm për të siguruar përforcimin e strukturës. Nëse jeni duke përdorur tel, sigurohuni që t'i lidhni të dyja drejtimet diagonale. Mund të përforconi strukturën në këndet e saj duke kontraventuar (duke përforcuar lidhjen) me copa të vogla druri.



Vizatim: E. Crété

Lidhja e elementeve të drurit

- Lënda drusore zakonisht lidhet me gozhdë, kunjë, vida ose bulona. Mund të përdorni shiritë metalikë ose pllaka lidhëse metalike (pllaka metalike të fiksuara mes dy ose më shumë elementëve drusorë në pikën e bashkimit të tyre) që shërbejnë për të forcuar lidhjet e drurit në pikën e bashkimit të tyre.

- Mbërthimi i një lidhjeje me një gozhdë të vetme nuk e siguron atë nga përdredhja. Është më mirë që këndi të gozhdohet nga të dy anët në mënyrë që gozhdët të mos nxirren lehtë dhe në këtë mënyrë të fiksohet më mirë lidhja.
- Në një mjedis shumë gërryes (për shembull, afër oqeanit), përdorni kunjat ose pykat / kushakët e drurit për të lidhur elementet. Këtu do ju nevojitet ndihma e një marangozi.
- Gjithashtu mund të përdorni litar ose kavo rrethimi të galvanizuar me rezistencë të lartë. Kur përdorni fibra natyrale, lagini para se t'i përdorni pasi ato do të tkurren gjatë tharjes dhe do ta shtrëngojnë më fort pjesën e lidhjes.




Lidhja e elementeve të bambusë

- Nëse po përdorni bambu për të ndërtuar një strukturë, mos përdorni gozhdë. Përdorni litar ose kavo të galvanizuar për rrethime me rezistencë të lartë. Kur përdorni fibra natyrale, lagini para se t'i përdorni pasi ato do të tkurren gjatë tharjes dhe do ta shtrëngojnë nyjen.
- Lidhjet duhet të vendosen ndërmjet dy nyjeve të bambusë, pasi bambuja ndahet lehtë në skajet e saj.

Ankorimi i strukturës

- Mund ta fiksoni strukturën në tokë duke e ankoruar. Qendrueshmëria e ankorimit sigurohet nga fortësia dhe tërheqja e litarëve të përdorur, si dhe nga elementi i fiksuar mbi të cilin është lidhur dhe ankoruar struktura, si p.sh., një kunjë, pemë ose shtyllë.




Vizatim i përshtatur nga: Federata Ndërkombëtare e Shoqërive të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC). n.d. "The IFRC Shelter Kit". Gjenevë, IFRC.

- Kontrolloni rezistencën e elementeve ekzistuese përreth përpara se të ankoroni strukturën në to, ose para se të bëni një ankorim të ri.
- Nëse mund të gërmoni tokën, mund të përdorni një kunj ose të ngulni në tokë ndonjë objekt që ofron rezistencë, dhe më pas lidheni atë me një litar ose me kavo teli që dalin mbi tokë.
- Nëse nuk mund të gërmoni tokën, mund të përdorni çdo objekt që është mjaftueshëm i rëndë për të ankoruar litarët, siç janë thasët me rërë (zallë) ose kovat e mbushura me dhe, rërë, gurë, gëlqere ose çimento.

Shtyllat stabilizuese

- Mund të inkastroni (stabilizoni) një shtyllë duke hapur një vrimë në tokë afërsisht 50 cm të thellë. Ngulni fundin e shtyllës duke ngjeshur rreth 10 cm tokë rreth saj. Përsëriteni procedurën derisa vrima të mbushet plotësisht dhe shtylla të qëndrojë e fiksuar mirë. Nëse është e mundur, shtoni 5% gëlqere ose çimento në dheun që po përdorni për të mbushur vrimën.
- Mund të përdoren pyka për të përmirësuar qëndrueshmërinë e një shtylle. Gjithashtu mund të shtoni një ankorë druri në bazën e saj për t'i rritur sipërfaqen dhe për të ulur qendrën e saj të gravitetit.




Vizatim i përshtatur nga: Federata Ndërkombëtare e Shqipërisë të Kryqit të Kuq dhe Gjymëhënës së Kuqe (IFRC). n.d. "The IFRC Shelter Kit". Gjenevë, IFRC.

- Nëse nuk mund të gërmoni tokën, mund të grumbulloni thasë me rërë rreth shtyllës ose ta vendosni shtyllën në kova të mëdha të mbushura me dhe, rërë, gurë, gëlqere ose çimento.

Si të rregulloni një mushama

- Nëse mushamaja nuk ka vrima për lidhje dhe ju dëshironi ta rregulloni atë në një piketë ose kunj duke përdorur një litar, atëherë kapni fundin / cepin e saj dhe bëni një nyjë. Kalojeni litarin përmes nyjës. Ose, mbështillni një gur të vogël në buzën e jashtme të mushamasë. Lidhjeni litarin rreth tij dhe bëni një nyjë. Për të shmangur grisjen e mushamasë kur e gozhdoni, mbështilleni fundin e saj rreth një liste / petavre druri para se ta gozhdoni, ose përdorni një unazë plastike apo një kapak shisheje. Mushamaja e gozhduar pa mbrojtje do të shqyhet shpejt, veçanërisht nëse është me cilësi të ulët.
- Për të shmangur grumbullimin e ujit, mushamaja duhet të shtrihet dhe të tendoset fort, si një lëkurë daulleje, mbi një strukturë që ka një pjerrësi jo më shumë se 30 gradë. Kushtojini vëmendje dhe sigurohuni që uji të mos kullojë në një zonë të ndjeshme, veçanërisht nëse përdorni mbulesa të mëdha mushamaje, pasi ato mund të mbledhin një sasi të madhe uji.




- Mund ta fiksoni mushamanë duke gërmuar një kanal ku të fusni fundin e saj dhe duke e mbuluar me dhe. Ju gjithashtu mund të mbështillni gurë në copën e gomuar para se ta groposni. Gurët duhet të jenë më të mëdhenj se një grusht për të shmangur grisjet.
- Nëse dëshironi të bashkoni mushamatë duke i qepur ato, paloseni disa herë mushamanë në mënyrë që fija e qepjes të kalojë nëpër disa shtresa të copës së gomuar.
- Sigurohuni që mushamatë të mos jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me sipërfaqet e dekoruara pa pasur një shtresë mbrojtëse në mes. Vini re: nëse nuk janë të lidhura në mënyrë të sigurt, mushamatë mund t'i marrë era nëse është e fortë. Në këtë situatë, ato nuk janë më efektive si pajisje mbrojtëse dhe mund t'i gërvishtin zbukurimet e sipërfaqes së jashtme të objekteve.



Sigurohuni që të mos e bllokoni ventilimin e hapësirave të brendshme gjatë mbulimit të tyre. Së pari, sepse mungesa e ventilimit mund të ndikojë negativisht te elementet që duhet të mbrohen, sidomos nëse ato janë të lagura. Së dyti, sepse kalimi i rrymave të duhura të ajrit zvogëlon riskun që mbulesa të shkulet nga era. Është e rëndësishme të lejoni vende ajrimi pikërisht nën strehën e përkohshme – për shembull, duke lënë një hapësirë prej 10 cm midis mureve dhe mbulesës së përkohshme.

Fiksimi i fletëve të valëzuara të llamarinës ose çelikut

Për të arritur hidroizolin me fletë llamarine (CGI) ose çeliku (CGS) të galvanizuar dhe të valëzuar, duhet të mbivendosni dy valëzime nga secila fletë në drejtimin anësor, dhe minimumi 15 cm për së gjati, si dhe t'i fiksoni fletët së bashku me gozhdë me kokë të madhe në pjesën e sipërme të valëzimit.



Vizatim i përshtatur nga: Federata Ndërkombëtare e Shoqërive të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC). n.d. "The IFRC Shelter Kit". Gjenevë, IFRC.



International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies (IFRC). n.d. *The IFRC Shelter Kit*. Geneva, IFRC. E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/Ry5Z-DEU3>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies (IFRC). 2015. *IFRC bamboo frame for emergency shelters and emergency roofs: technical sheets*. Geneva, IFRC.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/S7YY-78MG>

Udhëzues për ndërtimin hap pas hapi të pajandrave të thjeshta prej druri



Teksti i mëposhtëm ofron udhëzime të përgjithshme për ndërtimin e llojeve të ndryshme të pajandrave të drurit për stabilizimin emergjent të strukturave të trashëgimisë kulturore. Sidoqoftë, për të përzgjedhur llojin më të përshtatshëm të pajandrës, këshillohuni me një inxhinier konstruktor që i njeh strukturat lokale të trashëgimisë dhe materialet e tyre të ndërtimit.



Kini parasysh se në rast emergjence, pajandimi është teknika e mbështetjes dhe e përforcimit së elementeve të ndërtuara kur një strukturë rrezikon të shembet.


Për më shumë informacion mbi hapat e punës që duhen ndjekur në zbatimin e pajandimit dhe veprimeve të tjera të stabilizimit emergjent, referojuni *Udhëzuesit*, faqet 108-115.

1 Pykat

Pykat apo kushakët përdoren për të fiksuar pajandrat e drurit me strukturën që po stabilizohet. Ato mund të ndihmojnë për të mbushur boshllëqet e vogla midis pjesëve të drurit dhe për ta bërë më të lehtë ndërtimin e pajandrës. Ndiqni udhëzimet e mëposhtme hap pas hapi për të mësuar se si t'i përdorni ato.


Mjetet e nevojshme: sharrë, çekiç

Hapi 1: Merrni një copë druri dhe prijeni atë diagonalisht duke formuar dy pyka:




Vizatimi: Nelson Vila Pouca

Hapi 2: Vendoseni pykën e parë në boshllëkun që duhet të mbushet, pastaj përdorni gozhdët për të penguar rrëshqitjen e pykës. Vendoseni pykën tjetër në boshllëkun e mbetur dhe përdorni një çekiç për ta shtyrë pykën derisa të fiksohet fort midis pjesëve të tjera të drurit.



Vizatimi : Nelson Vila Pouca

Hapi 3: Përdorni gozhda për të fiksuar pykën e dytë.



Vizatimi: Nelson Vila Pouca




Lidhjet e gozhduara

Mundohuni të lini një largësi minimale prej afërsisht 3 cm midis çdo gozhdë dhe 5 cm midis gozhdëve dhe fundit të drurit. Gozhdët duhet të jenë të lyera me lëndë që frenon ndryshkjen.

2 Pajandra e thjeshtë vertikale, tipi 1

Mjetet e nevojshme: sharrë, çekiç


Pajandra në formë “T”-je e paraqitur më poshtë është një puntelë e përkohshme që mund të instalohet shpejt, por mund të bëhet e paqëndrueshme nëse nuk vendoset saktë në qendër të rëndesës së ngarkesës. Duhet të ndërtohet me idenë se do të përdoret përkohësisht, para ndërtimit të pajandrave më të qëndrueshme siç është pajandra dopio “T”.



Vizatimi: Nelson Vila Pouca


Hapi 1: Përgatitni të gjitha pjesët e drurit dhe pastroni zonën ku dëshironi të vendosni pllakën e poshtme mbajtëse të drurit apo tabanin.

Hapi 2: Gozhdoni së bashku traun e kreut dhe kolonën e drurit, duke përdorur dy pllaka druri përforcuese, nga një në secilën anë.




Vizatimi: Nelson Vila Pouca

Hapi 3: Vendosni pllakën mbajtëse horizontale të drurit në tokë (mund të jetë e nevojshme të vendosni dërrasa midis pllakës mbajtëse dhe tokës, nëse toka është shumë e butë) fill poshtë traut që dëshironi të stabilizoni, dhe vendosni pykën e parë mbi të. Vendosni një gozhdë në pllakën e drurit për të fiksuar pykën. Vendoseni pykën e dytë mbi pykën e parë dhe vendosni pjesën kolonë / tra të kulmit mbi pykën e dytë. Godisni dhe ngulni pykën e dytë, derisa trau i kulmit të puthitet fort me traun që duhet të stabilizoni. Vendosni një gozhdë për të penguar rrëshqitjen e pykës së dytë.



Vizatimi: Nelson Vila Pouca


Hapi 4. Përfundojeni punën duke vendosur një pllakë përforcuese për të lidhur kolonën dhe pllakën mbajtëse horizontale të bazamentit të drurit



Vizatimi: Nelson Vila Pouca

3 Pajandër e thjeshtë vertikale, tipi 2


Pajandra vertikale e paraqitur më poshtë është gjithashtu një puntelë e përkohshme, e cila mund të instalohet shpejt, por mund të bëhet e paqëndrueshme nëse nuk vendoset mirë në qendër të ngarkesës. Kjo lloj pajandre ndërtohet para instalimit të pajandrave më të qëndrueshme.



Vizatimi: Nelson Vila Pouca


Hapi 1: Përgatitni të gjitha pjesët e drurit dhe pastroni zonën ku dëshironi të vendosni pllakën mbajtëse të poshtme të drurit apo tabanin.

Hapi 2: Gozhdojini së bashku traun e kreut dhe kolonën duke përdorur dy pllaka përforcuese, nga një në secilën anë. Gozhdojini së bashku traun e kreut dhe kolonën vertikale. Gozhdoni dy kontrafortë diagonalë në traun e kreut dhe në kolonë, në të dy krahët e kolonës.




Vizatimi: Nelson Vila Pouca

Hapi 3: Vendoseni pllakën mbajtëse në tokë (mund të jetë e nevojshme të vendosni dërrasa midis tabanit dhe tokës, nëse toka është shumë e butë) fill nën traun që dëshironi të stabilizoni, dhe vendosni pykën e parë mbi të. Fiksojeni pykën me një gozhdë në taban. Vendoseni pykën e dytë sipër pykës së parë dhe vendosni shtyllën / traun e kreut mbi pykën e dytë. Goditeni me çekiç pykën e dytë, derisa trau i kreut të pajandres të puthitet fort me traun e strukturës së rrezikuar që dëshironi të stabilizoni. Vendosni një gozhdë për të penguar rrëshqitjen e pykës së dytë.




Vizatimi: Nelson Vila Pouca

Hapi 4: Përfundojeni punën duke vendosur dy kontraforte diagonale për të lidhur shtyllën vertikale dhe pllakën mbajtëse të poshtme prej druri.



Vizatimi: Nelson Vila Pouca

Në varësi të natyrës së emergjencës, të llojit të dëmtimit dhe të materialeve që dispononi, mund të përdoren edhe lloje të tjera të pajandrave vertikale. Vizatimi i mëposhtëm ilustron një variant.



Vizatimi: Nelson Vila Pouca


4 Pajandër e pjerrët me traversë

Pajandra e pjerrët e treguar më poshtë është një pajandër paneli, mbështetësi i së cilës nuk prek në dysHEME ose tavan: është e përkohshme dhe përdoret për të bërë të mundur heqjen e sigurt të inerteve që janë grumbulluar pranë bazës së një muri.


Paneli mbështetës apo veshja me dërrasa e murit duhet të fiksohet në mur me shpime (nëse është një mur me tullë ose gurë) ose me gozhda (nëse është mur prej druri). Nëse muri ka zburime, sigurohuni që të vendosni një shtresë të ndërmjetme izoluese, sipas faqes 114 të *Udhëzuesit*.

Paneli mbështetës i murit nuk ka nevojë të fiksohet nëse pjesa e sipërme dhe e poshtme e tij mbështeten në dysHEME apo në tavan por, por pa krijuar fërkime.

Nëse nuk ka pengesa pranë bazës së murit, mund të përdoret edhe pajandra e pjerrët e ilustruar në faqen 87.



Vizatimi: Nelson Vila Pouca



Vizatimi: Nelson Vila Pouca


Mjetet e nevojshme: çekiq, sharrë dhe trapan, nëse planifikoni të fiksoni panelin mbështetës në mur duke përdorur vida, ose nëse doni të përdorni piketat për fiksimin e traut mbështetës ankorues.



5 Pajandimi i dyerve ose dritareve, tipi 1

Kjo pajandër përdoret për të stabilizuar hapjet në rastet kur janë të dëmtuara kornizat e dyerve apo të dritareve.

Mjetet e nevojshme: sharrë, çekiç



Vizatimi: Nelson Vila Pouca

Hapi 1: Bëjini gati të gjitha elementet e drurit dhe pastroni kornizën e hapjes që do të pajandohet.

Hapi 2: Instaloni bazamentin me një sërë pykash në njërin skaj dhe gozhdojini ato së bashku njëkohësisht, derisa bazamenti të fiksohet mirë. Bazamenti duhet të jetë i niveluar sa më shumë që të jetë e mundur. Përdorni spesorë nivelues nën pllakën mbajtëse horizontale të drurit nëse është e nevojshme.

Hapi 3: Instaloni traun e kreut me një grup pykash me drejtim në skajin e kundërt të pykave të bazamentit dhe gozhdojini pykat me traun e kreut njëkohësisht, derisa trau të jetë shtrënguar. Trau i kreut duhet të jetë sa më i niveluar. Përdorni spesorë nivelues mbi traun e kreut nëse është e nevojshme.

Hapi 4: Instaloni shtyllën e majtë nën traun e kreut dhe mbi taban dhe nëse duhet fiksojeni me pykë dhe spesorë nivelues.

Hapi 5: Instaloni shtyllën e djathtë dhe fiksojeni me anë të pykave dhe spesorëve nivelues midis traut të kreut dhe tabanit.



Hapi 6: Instaloni shtyllën e mesit me një sërë pykash midis shtyllës dhe tabanit.




Hapi 7: Shtrëngojeni dhe tendoseni strukturën, duke goditur pykat.

Hapi 8: Gozhdoni dy dërrasat diagonale.

6 Pajandër për dyer dhe dritare, tipi 2 dhe 3

Këto pajandra përdoren për të stabilizuar hapjet në rastet kur kornizat e dyerve ose të dritareve janë dëmtuar dhe është e nevojshme të përdorni këtë hapësirë që të hyni në brendësi të ndërtesës.

Mjetet e nevojshme: sharrë, çekiq



Vizatimi: Nelson Vila Pouca



Këshilla për ndërtimin e pajandrave

- Përdorni lëndë drusore me një gjatësi jo më të madhe se 25 herë gjerësinë e saj, në mënyrë që të jetë rezistente në shtypje, dhe që rreziku i deformimit të jetë i ulët.
- Pykat janë pjesë të ndjeshme; përdorni dru që nuk përmban asnjë nyjë ose defekt dhe që është i thatë mjaftueshëm për të mos u shformuar.
- Gjithmonë duhet të fiksoni pllakën mbështetëse me binarë në mur për të parandaluar ndonjë rrëshqitje të pajandërës. Mos u mjaftoni me forcën e fërkimit të krijuar nga mbështetja.
- Pllakat me binarë druri për mbajtjen e murit duhet të zgjaten sa më lart të jetë e mundur përgjatë murit të dëmtuar dhe nëse është e mundur, të arrijnë deri në tokë.
- Mund të vendosni thasë me rërë midis murit dhe pllakës për të përmirësuar kontaktin midis tyre, për shembull, nëse sipërfaqja e murit nuk është e sheshtë.
- Sa herë që të keni mundësi, shmangni pajandimin e një muri me një sipërfaqe të dekoruar. Nëse nuk mund ta shmangni, mund të vendosni pëlhurë pambuku / napë dhe sfungjerë midis murit dhe pllakës për mbajtjen e murit. Kur përcaktoni madhësinë e pllakës për mbajtjen e murit, kini parasysh që do t'ju duhet ta fiksoni pllakën në mur.
- Në rast të një shembje të pjesshme në bazën e një muri, mund të përdorni thasë me rërë për të mbushur boshllëkun e krijuar dhe për të siguruar një mbështetje të përkohshme.



Department of Homeland Security. 2011. *Field guide for Building Stabilization and Shoring Techniques*. Washington, DC, U.S. Department of Homeland Security.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/ZN3R-NRWU>

Corpo Nazionale dei Vigili del Fuoco – Università degli Studi di Udine. 2011. *Manuale Opere Provvisoriali, l'intervento tecnico urgente in emergenza sismica*. Rome, Ministero dell'Interno.

E disponueshme (në italisht) në: <https://perma.cc/AP8A-22L2>

Grimaz, S., Cavriai, M., Mannino, E., Munaro, L., Bellizzi, M., Bolognese, C., Caciolai, M., D'Odorico, A., Maiolo, A., Ponticelli, L., Barazza, F., Malisan, P. & Moretti, A. 2010. *Vademecum, STOP, Shoring Templates and Operating Procedures for the Support of Buildings damaged by Earthquakes*. Rome, Ministry of Interior – Italian Fire Service.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/62JX-UGLP>

United States Army Corps of Engineers. 2013. *Urban Search & Rescue Shoring Operations Guide*. Washington, DC, United States Department of Defence.

E disponueshme në adresën: <https://perma.cc/H6NA-WBRY>





Këshilla për tharjen “in situ” të objekteve të luajtshme të trashëgimisë kulturore

- Shmangni përdorimin e ujit me presion të lartë kur pastroni sipërfaqet. Presioni mund të shkaktojë dëme shtesë në materiale të brishta dhe të përhapë mikroorganizmat e dëmshëm. Përdorni mjete plastike dhe ujë të pastër të rrjedhshëm për të hequr baltën dhe inertet nga sipërfaqet. Mjetet plastike shkaktojnë më pak dëme sesa ato metalike.
- Ventilatorët mekanikë mund të përdoren për të përshpejtuar procesin e tharjes, por ato nuk mund të zëvendësojnë hapjen e dyerve dhe të dritareve, proces i cili është i nevojshëm për largimin e lagështisë nga ndërtesa.
- Mos përdorni ngrohës me gaz, pasi ata prodhojnë avuj uji.
- Kini parasysh që temperaturat mbi 18 °C mund të favorizojnë krijimin dhe rritjen e mykut.
- Shmangni përdorimin e aparateve të fuqishëm të heqjes së lagështisë në ndërtesat e vjetra. Si aparatet që heqin lagështinë me anë të tharjes, ashtu edhe ato që e heqin me anë të ngrirjes, mund të kontrollohen nëpërmjet një aparati për matjen e lagështisë (humidistat). Nëse këto kontrole kryhen në mënyrën e duhur, këto aparatura mund të krijojnë kushte optimale për tharjen.

Për sipërfaqet e dekoruara

- Para se të prekni ndonjë sipërfaqe të dekoruar, merrni këshilla, ose siguron praninë e një restauratori me përvojë në lidhje me pikturat murale ose mozaikët.
- Mundohuni të largoni lagështirën nga sipërfaqja e dekoruar. Kini kujdes nga dyshemetë e papërshekueshme nga uji që pengojnë drenazhimin e ujit në dysheme dhe përshpejtojnë ngjitjen e lagështirës në mure.
- Nëse muri është i dekoruar vetëm në njërën anë, përpiqui ta tërhiqni dhe ta thani ujin nga ana e padekoruar. Ngadalësojeni tharjen në anën e dekoruar, duke përdorur mushama. Parandaloni kontaktin e drejtpërdrejtë me sipërfaqen e dekoruar duke përdorur pëlthurë / napë pambuku pa ngjyrë ose çarçaf të bardhë pambuku.
- Nëse dalloni një shtresë të hollë dhe të bardhë që po krijohet në sipërfaqe, kjo shpesh është shenjë e kristalizimit të kripërave në sipërfaqe. Dokumentoni vendet ku dallohet kjo dukuri dhe pyesni një restaurator si ta hiqni atë. Ju mund t'i pastroni në të thatë me një furçë kripërat që kristalizohen në sipërfaqe. Ky veprim parandalon që kripërat të treten përsëri dhe të përthithen sërish nga muri.

Materialet dhe pajisjet për stabilizimin emergjent “in situ” të strukturave dhe për mbrojtjen e elementeve dekorative



- ☐ Trarë druri ose prej bambuje për të ndërtuar një strukturë të përkohshme
- ☐ Mushama: me thurje të dendur dhe spesor të trashë, që i duron mirë kushtet e këqija të motit. Nëse është e mundur, përdorni mushama me ngjyrë të bardhë për të penguar ngritjen e tepërt të temperaturës dhe mushama me breza përforcimi me vrima në anë për të shmangur grisjen.
- ☐ Fletë llmarine ose çeliku të valëzuar dhe të galvanizuar (CGI / CGS): kini kujdes nga fletët me cilësi të ulët CGI / CGS, pasi këto dëmtohen shumë shpejt. Fletët me një trashësi minimale prej 0.3 mm zakonisht zgjasin për disa vite.
- ☐ Gozhdë, veçanërisht gozhdë me kokë të madhe për fiksimin e fletëve CGI / CGS.
- ☐ Çekanë, sharra, vida, kaçavida, dalta druri dhe bulona.
- ☐ Metër shirit, plumbçe dhe nivela dore.
- ☐ Tela: tela rezistentë të galvanizuar mund të përdoren për të fiksuar drurin e bambusë dhe mushamanë, ose për të lidhur dhe fiksuar një strukturë.
- ☐ Shirita metalikë ose pllaka lidhëse metalike (pllaka metalike të fiksuara mes dy ose më shumë elementeve drusore në pikën e bashkimit të tyre) që shërbejnë për të forcuar lidhjet e drurit në pikën e bashkimit të tyre
- ☐ Litar i përbërë nga fibra natyrale për të fiksuar / lidhur bambu dhe mushama ose për të ankoruar një strukturë
- ☐ Kunja dhe piketa për ankorimin e një strukture ose për fiksimin e një mushamaje
- ☐ Gurë dhe thasë me rërë: për ankorimin e një strukture ose për fiksimin e një mushamaje.
- ☐ Lopata dhe kazma: në rast se duhet të gërmoni një gropë për të ankoruar strukturën ose për të fiksuar mushamanë.
- ☐ Kova për ankorimin e shtyllave, në rast se nuk mund të gërmoni një gropë.
- ☐ Çimento ose gëlqere: këto materiale mund të ndihmojnë në ankorimin e shtyllave në mënyrë të qëndrueshme.

- ☐ Pyka druri: mund të ndihmojnë në stabilizimin dhe qëndrueshmërinë e një shtylle.
- ☐ Unaza plastike, kapakë shishesh dhe dërrasa të vogla druri për të bashkuar një mushama me një strukturë.
- ☐ Materiale për qepje (gjilpëra dhe spango) ose ngjitës shirit të fortë (rezistent ndaj ujit, i përforcuar dhe i ndjeshëm ndaj trysnisë) për të bashkuar me njëra-tjetrën disa mushama.

Për tharjen e strukturave të lagura

- ☐ Rrjetë teli ose panele me vrima për të siguruar hapjet, pa ndaluar qarkullimin e rrymave të ajrit
- ☐ Lopata, fshesa dhe karroca dore për të hequr baltën dhe inertet. Kur është e mundur, zgjidhni lopata dhe fshesa plastike kundrejt atyre metalike, pasi shkaktojnë më pak dëme
- ☐ Pompa ose kova për të hequr ujin e bllokuar
- ☐ Furça plastike dhe ujë i pastër dhe i rrjedhshëm për të hequr baltën dhe inertet nga sipërfaqet
- ☐ Një matës lagështie ose multimetër për të matur lagështinë në mure
- ☐ Ventilatorë mekanikë për të shpejtuar procesin e tharjes
- ☐ Mund të përdoren aparate ngrohëse, por mos përdorni kurrë ngrohës me gaz, pasi ato prodhojnë avuj uji. Kini parasysh që temperaturat mbi 18 °C gjithashtu mund të favorizojnë formimin dhe rritjen e mykut.
- ☐ Aparatet për eliminimin e lagështirës përmes ngrirjes ose tharjes mund të kontrollohen nëpërmjet një matësi lagështie për të siguruar kushte të përshtatshme tharjeje. Shmangni përdorimin e aparateve të fuqishëm të heqjes së lagështisë në ndërtesat e vjetra.
- ☐ Mushamaja mund të ndihmojë për të kontrolluar tharjen e një sipërfaqeje të dekoruar. Parandaloni kontaktin e drejtpërdrejtë me sipërfaqen e dekoruar duke përdorur napë pambuku të bardhë ose çarçaf të bardhë.

Për pajandim bazik

- ☐ Çekanë, sharra, vida, kaçavida, dalta druri dhe bulona
- ☐ Metër shirit, plumbçe dhe nivel dore
- ☐ Trarë druri dhe dërrasa me cilësi të mirë (për shembull, prej “Bredhi Douglas” ose “Pishë e Jugut”).

- ☐ Gozhdhë: 8d (diametri: 3.5 mm; gjatësia: 5 cm) dhe 16d (diametri: 3.7 mm; gjatësia: 8 cm).
- ☐ Puntela standarde metalike me lartësi të rregullueshme.
- ☐ Thasë me rërë, gomë ose material ambalazhues - “shkumë” - prej polietileni (zakonisht shitet si ‘Ethafoam’) për të mbrojtur sipërfaqet ose për të përmirësuar kontaktin midis një pllake me binarë të mbështetur në mur dhe vetë murit.
- ☐ Napë e bardhë natyrale ose pambuk i bardhë për të mbrojtur sipërfaqet nga gërvishtjet.



Për lidhjen e një strukture me fasho shtrënguese

- ☐ Fasho poliestri me kriketë dhëmbëndaluese (minimumi 2 mm e trashë dhe 50 mm - 75 mm e gjërë)
- ☐ Pllaka çeliku për t’u vendosur midis fashës dhe murit / kolonës për të shpërndarë ngarkesat
- ☐ Pllaka druri ose petavra (afërsisht 3 cm të trasha) për t’u vendosur midis pllakës së çelikut dhe murit / kolonës
- ☐ Gomë ose material ambalazhues - “shkumë” - prej polietileni (zakonisht shitet si ‘Ethafoam’) mund të mbrojë më tej sipërfaqet dhe të përmirësojë kontaktin midis një pllake me binarë të mbështetur në mur dhe vetë murit.
- ☐ Napë e bardhë natyrale ose pambuk i bardhë për të mbrojtur sipërfaqet nga gërvishtjet.

Materiale dhe pajisje për mbrojtjen “in situ” të sipërfaqeve të dekoruara


- ☐ Mushama për të mbrojtur sipërfaqet nga uji
- ☐ Thasë me rërë për të mbështetur sipërfaqet e dekoruara dhe për t’i mbrojtur ato nga goditjet (sigurohuni që thasët me rërë të mos marrin lagështi)
- ☐ Gomë ose material ambalazhues - “shkumë” - prej polietileni (zakonisht shitet si ‘Ethafoam’), për të përmirësuar kontaktin midis sipërfaqes dhe pllakave të drurit apo të çelikut, nëse do jetë e nevojshme
- ☐ Napë e bardhë natyrale ose pambuk i bardhë për të mbrojtur sipërfaqet nga gërvishtjet
- ☐ Pllaka druri ose çeliku për të shpërndarë ngarkesat, në rast se duhet të pajtoni ose të krijoni mbështetje për një element me sipërfaqe të dekoruar (dysheme, tavan, mur, kolona etj.)



Trarë druri



Matës lagështie



Puntela lartësie



Fletë llamarine (CGI)




Rrjetë teli (e hollë)



Rrjetë teli (e gjerë)



Pyka druri



Kunja dhe piketa



Lopatë dhe kazmë



Nivelë dore



Shirit metalik




Fasho poliestri me
kriketë dhëmbënda-
luese



Plumbçe



Pllaka druri / petavra

The image features a solid orange background. Two white diagonal lines are present: one starts from the left edge and extends towards the center, and the other starts from the right edge and extends towards the center, creating a sense of depth or a stylized 'X' shape.

REFERENCA

Hapi 2: Vlerësimi në vend i dëmit dhe riskut pas ngjarjes

BC Housing. 2018. *Rapid Damage Assessment*. Burnaby, BC Housing. I disponueshëm në: <https://www.bchousing.org/about/rapid-damage-assessment> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/686P-5JFE>

Connecticut Technology Transfer Center. 2010. *Protective Equipment for Workers in Hurricane Flood Response*. Connecticut, School of Engineering, University of Connecticut. I disponueshëm në: <https://www.t2center.uconn.edu/pdfs/SAFETY%20BRIEF%202010-7.pdf> [Accessed 9 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/LG2T-FTDZ>

Heritage Collections Council. 1998e. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Managing People*. Canberra, Heritage Collections Council. I disponueshëm në: https://aiccm.org.au/sites/default/files/docs/reCollections/5_managing_people.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/RR45-BJDW>

Hapi 3: Sigurimi dhe stabilizimi

Australian Institute for the Conservation of Cultural Material. 2017. *Visual Glossary*. Canberra, Australian Institute for the Conservation of Cultural Material. I disponueshëm në: <https://aiccm.org.au/conservation/visual-glossary> [Accessed 22 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/4P8N-5GBP>

Australia International Council on Monuments and Sites (ICOMOS). 2013. *The Burra Charter: The Australia ICOMOS Charter for Places of Cultural Significance, 2013*. Burwood, ICOMOS. I disponueshëm në: <http://australia.icomos.org/wp-content/uploads/The-Burra-Charter-2013-Adopted-31.10.2013.pdf> [Accessed 21 June 2017].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/ULL9-UY9U>

Australian War Memorial. n.d. Conservation advice: *Cleaning Soot Damaged Objects*. Canberra, The Australian War Memorial. I disponueshëm në: <https://www.awm.gov.au/about/our-work/projects/soot> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/Q38H-G6KT>

Canadian Conservation Institute. 2007. Vacuum Freeze-drying Archaeological Artifacts. *Canadian Conservation Institute (CCI) Notes 4/2*. Ottawa, Minister of Public Works and Government Canada. I disponueshëm në: <https://www.canada.ca/en/conservation-institute/services/conservation-preservation-publications/canadian-conservation-institute-notes/vacuum-freeze-drying-archaeological-artifacts.html> [Accessed 12 October 2017].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/QRP8-LYKA>

Canadian Conservation Institute. 2017. *Agents of Deterioration*. Ottawa, Minister of Public Works and Government Canada, Ottawa. E disponueshme në adresën: <https://www.canada.ca/en/conservation-institute/services/agents-deterioration.html> [Accessed 22 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/S65F-KNA5>

Canadian Conservation Institute. 2017. *Care of Objects and Collections*. Ottawa, Minister of Public Works and Government. I disponueshëm në: <https://www.canada.ca/en/conservation-institute/services/care-objects.html> [Accessed 22 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/ZDG8-Y4UU>

Corpo Nazionale dei Vigili del Fuoco – Università degli Studi di Udine. 2011. Manuale Opere Provvisorie, l'intervento tecnico urgente in emergenza sismica. Rome, Ministero dell'Interno. I disponueshëm (në gjuhën Italiane) në: <http://www.vigilfuoco.it/allegati/STOP/ManualeSTOP.pdf> [Accessed 24 October 2017].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/AP8A-22L2>

Department of Homeland Security Federal Emergency Management Agency (FEMA). 2009. *FEMA National US&R Response System Structural Collapse Technician Module 2a Shoring Basics*. Washington, DC, FEMA. I disponueshëm në: <https://www.fema.gov/pdf/emergency/usr/module2a.pdf> [Accessed 29 April 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/WF28-Q5QU>

Department of Homeland Security Federal Emergency Management Agency (FEMA). 2018. *Reclaiming Precious Heirlooms From Flood Waters*. Washington, DC, U.S. Department of Homeland Security. I disponueshëm në: <https://www.fema.gov/news-release/2003/09/23/reclaiming-precious-heirlooms-flood-waters> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/XY64-GPM6>

Department of Homeland Security Science and Technology Directorate, Infrastructure Protection and Disaster Management Division. 2011. *Field guide for Building Stabilization and Shoring Techniques*. Washington, DC, U.S. Department of Homeland Security. I disponueshëm në: <https://www.dhs.gov/xlibrary/assets/st/st-120108-final-shoring-guidebook.pdf> [Accessed 24 October 2017].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/ZN3R-NRWU>

Grimaz, S., Cavriai, M., Mannino, E., Munaro, L., Bellizzi, M., Bolognese, C., Caciolai, M., D'Odorico, A., Maiolo, A., Ponticelli, L., Barazza, F., Malisan, P. & Moretti, A. 2010. *Vademecum, STOP, Shoring Templates and Operating Procedures for the Support of Buildings damaged by Earthquakes*. Rome, Ministry of Interior – Italian Fire Service. I disponueshëm në: http://sprint.uniud.it/sites/default/files/Vademecum_STOP_eng_0.pdf [Accessed 24 October 2017].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/62JX-UGLP>

Heritage Collections Council. 1998a. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Caring for Cultural Material 1*. Canberra, Heritage Collections Council. I disponueshëm në: https://aiccm.org.au/sites/default/files/docs/reCollections/1_caring_for_cultural_material_1.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/9DS2-DRPA>

Heritage Collections Council. 1998b. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Caring for Cultural Material 2*. Canberra, Heritage Collections Council. I disponueshëm në: https://aiccm.org.au/sites/default/files/docs/reCollections/2_caring_for_cultural_material_2.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/49CQ-QVUV>

Heritage Collections Council. 1998d. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Managing Collections*. Canberra, Heritage Collections Council. I disponueshëm në: https://aiccm.org.au/sites/default/files/docs/reCollections/4_managing_collections.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/5NAY-J562>

Heritage Collections Council. 1998f. *reCollections, Caring for Collections Across Australia – Handling, Transportation, Storage and Display*. Canberra, Heritage Collections Council. I disponueshëm në: https://aiccm.org.au/sites/default/files/docs/reCollections/6_htsd.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/5XRJ-U9R3>

Historic England. 2015. *Flooding and Historic Buildings*. Sëindon, Historic England. I disponueshëm në: <https://content.historicengland.org.uk/images-books/publications/flooding-and-historic-buildings-2ednrev/heag017-flooding-and-historic-buildings.pdf/> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/M66M-3E8L>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. n.d. *The IFRC Shelter Kit*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. I disponueshëm në: <http://www.ifrc.org/PageFiles/95526/publications/D.03.a.07.%20IFRC%20shelter-kit-guidelines-EN-LR.pdf> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/R5Y5-DEU3>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. 2015. *IFRC bamboo frame for emergency shelters and emergency roofs – Technical sheets*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. I disponueshëm në: <http://www.ifrc.org/Global/Documents/Secretariat/Shelter/IFRC-bamboo-frame-A4-FINAL-EN-2015.pdf> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/S7YY-78MG>

Levitani, A. 1993. Emergency Treatment for Water-Soaked Furniture and Wooden Objects. *National Parks Service Conserve O Gram*, 7(7). Washington, DC, U.S. Department of the Interior. I disponueshëm në: <https://www.nps.gov/museum/publications/conserveogram/07-07.pdf> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/4J9T-SFVZ>

McCord, M., & Stone, T. 2002. *Deterioration of Collections. Generation 2: Education and Support Materials*. ICCROM material I papublikuar. Rome.

Russell, R. & Winkworth, K. 2009. *Significance 2.0: A guide to assessing the significance of collections*. Canberra, Collections Council of Australia Ltd. I disponueshëm në: <https://www.arts.gov.au/sites/g/files/net1761/f/significance-2.0.pdf> [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/GJ8G-ERAN>

State Library of Queensland. 2014a. *Caring for your collections: Salvaging water-damaged collections*. Brisbane, Queensland Government. I disponueshëm në: http://www.slq.qld.gov.au/data/assets/pdf_file/0005/128984/Caring-for-your-collections-Salvaging-water-damaged-collections.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/8V9X-YFNS>

State Library of Queensland. 2014b. *Caring for your collections: Freezing water-damaged and insect infested collections*. Brisbane, Queensland Government. E disponueshme në adresën: http://www.slq.qld.gov.au/__data/assets/pdf_file/0004/128983/Caring-for-your-collections-Freezing-water-damaged-and-insect-infested-collections.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/V6KB-XKZL>

Tandon, A. 2016. *Endangered Heritage: Emergency Evacuation of Heritage Collections*. Paris, UNESCO & Rome, ICCROM. I disponueshëm në: https://www.iccrom.org/wp-content/uploads/Endangered-Heritage_INTERACTIVE.pdf [Accessed 14 February 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/7J4C-TJDK>

United States Army Corps of Engineers. 2013. *Urban Search & Rescue Shoring Operations Guide*. Washington, DC, United States Department of Defence. I disponueshëm në: http://www.disasterengineer.org/LinkClick.aspx?fileticket=_qYQCrKH2k%3D&tabid=57&mid=394 [Accessed 14 July 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/H6NA-WBRY>

Van Balen, K. 2008. The Nara Grid: An evaluation Scheme Based on the Nara Document on Authenticity. *APT Bulletin*, 39(2/3): 39–45. I disponueshëm në: <http://orcp.hustoj.com/wp-content/uploads/2016/01/2008-The-Nara-Grid-An-Evaluation-Scheme-Based-on-the-Nara-Documents-on-Authenticity.pdf> [Accessed 17 January 2018].

Adresë e përhershme interneti: <https://perma.cc/DL8A-E32V>

#culturecannotwait
(kultura nuk mund të presë)



Prince Claus Fund for
Culture and Development

Herengracht 603
1017 CE Amsterdam
Holandë
+31 20 3449 160
www.princeclausfund.org



Rr. "Ismail Qemali", P.34/I Kt.
VII Zy.31, Tiranë, Shqipëri
+355 69 20 39 190
www.chwb.albania.org
Rr. "Nezir Gashi", nr.38,
Prishtinë, Kosovë*
+381 38 754 866
www.chwb.kosova.org



Via di San Michele 13
00153 Romë
Itali
+39 06585531
www.iccrom.org

ICCROM, Prince Claus Fund, Cultural Heritage without Borders, 2022

ISBN 978-92-9077-330-6
CHWB Albania ISBN 9789928801074
CHWB Kosovo* ISBN 9789951895750

Përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe
është mundësuar falë mbështetjes së
Prince Claus Fund dhe CER.



ISBN 978-92-9077-330-6



9 789290 773306 >

ISBN 978-9928-801-07-4



9 789928 801074

ISBN 978-9951-8957-5-0



9 789951 895750